



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 441 Akti

Nr. 395 Vendimi
Tiranë, më 8.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 4.6.2021, ora 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gentian Stoja**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës.**
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimet e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit edhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Gentian Stoja është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4.

2. Me vendimin e trupit gjykues të datës 8.1.2020 është vendosur kryesues komisionerja Xhensila Pine, si dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
3. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e tij.
4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.
5. Në datën 10.5.2020, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Stoja, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, si dhe ta ftojë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e tij.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore, ku paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit.
7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Stoja, në seancë dëgjimore, në datën 4.6.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në Tiranë.
8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 4.6.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic.
9. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, ku paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe në përfundim të saj kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

10. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.
11. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
 - a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
 - b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
 - c) informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit, nga institucionet ligjzbatuese;
 - ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, së bashku me materialin shoqërues;
 - d) dokumentet shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
 - dh) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
 - e) denoncimet nga publiku;
 - ë) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

12. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka konstatuar se për subjektin Gentian Stoja:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë dhe mosdeklarime;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

13. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse¹.

14. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Stoja, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar nga Komisioni, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të bëra nga subjekti në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

15. Në përfundim të hetimit administrativ, kur Komisioni krijoi bindjen se provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht për tri kriteret e rivlerësimit, t’i japë të drejtë subjektit të njihet me rezultatet e këtij hetimi, si dhe me të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

16. Mbështetur në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë, si vijon:

1. Apartament banimi me sip. 89.76 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Korçë, dhuruar nga prindërit dhe motra me Kontratën e Dhurimit nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 15.12.2011. Pjesa takuese: 100%.

1.1 Apartamenti i banimit është deklaruar për herë të parë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit (S. S. dhe E. S.) në Deklaratën e Interesave Private para Fillimit të Detyrës datë 29.12.2009, i fituar nga privatizimi i banesave shtetërore në vitin 1993 dhe pjesë takuese nga 30% secili.

1.2 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në Deklaratën e Interesave Private Vjetore të vitit 2011, si dhe në deklaratën e pasurisë *Vetting*, fitimin e këtij apartamenti banimi nëpërmjet dhurimit.

1.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Korçë ka konfirmuar për Komisionin këtë pasuri, me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2020, si dhe ka dërguar kopje të Kontratës së Dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2011. Sipas kontratës, dhuruesit S. S., E. S. dhe I. D. (S.) ia dhurojnë këtë pasuri palës pranuese të dhurimit, Gentian Stoja, në mënyrë të përvokueshme dhe pa kundërshpërbllim. Referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme, bashkëlidhur kontratës së dhurimit, rezulton se shuma e blerjes nga dhuruesit është 8,312 (tetë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë, kurse në datën 25.11.2011 është kryer rivlerësimi i kësaj pasurie në shumën 2,858,856 (dy milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë (para dhurimit). Taksa e rivlerësimit është paguar nga llogaria bankare e subjektit të rivlerësimit dhe është llogaritur në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

¹Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese: “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

1.4 Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri.

2. Automjet tip “Volkswagen Sharan”, me targa ***, viti i prodhimit 2006, blerë me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 4.4.2012, në vlerën 700,000 (shtatëqind mijë) lekë. Pjesa takuese: 100%.

2.1 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe në Deklaratën e Interesave Private Vjetore të vitit 2012 nuk deklaroi burimin e të ardhurave të përdorura për blerjen e automjetit. I pyetur nga Komisioni², subjekti deklaroi si burim të shumës 700,000 (shtatëqind mijë) lekë, për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Sharan”, me targa ***, gjendjen *cash* të deklaruar para fillimit të detyrës (viti 2009) në masën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.

2.2 Në Deklaratën e Interesave Private Vjetore të vitit 2018 është deklaruar shitja e këtij automjeti në vlerën 6,500 euro.

2.3 Sipas dokumentacionit në dosjen e DRSHTRR-së rezulton se:

a) Automjeti ka hyrë në territorin e Shqipërisë nga pika doganore e Kapshticës në datën 4.4.2012, i pajisur me targa ***, nga shtetasi E. D. Certifikata e Pronësisë e mëparshme e automjetit tregon se vendi i origjinës së tij ka qenë Austria me pronar z. I. I..

b) Sipas deklaratës doganore rezulton se zhdoganimi është kryer nga shtetasi E. D. dhe për automjetin është paguar TVSH-ja në doganë në shumën 226,064 (dyqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

c) Subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin me Kontratën nr. *** rep., dhe *** kol., datë 4.4.2012, nga shtetasi E. D., në shumën 700,000 (shtatëqind mijë) lekë, e cila është deklaruar e likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

2.4 Lidhur me përdorimin e gjendjes *cash* si burim në momentin e blerjes së automjetit dhe mosdeklarimin e tij si pakësim në vitin 2012, trupi gjykues nuk e mori në konsideratë pasi deklarimi i subjektit gjatë hetimit administrativ të Komisionit nuk përputhet me deklaratimet e tij periodike. Nga analiza financiare e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, rezulton se janë në pamundësi financiare deri në fund të vitit kalendarik për krijimin e kësaj shume dhe plotësimin e gjendjes *cash* në vlerën e deklaruar më herët prej tij (për më tepër detaje shihni analizën financiare të Komisionit).

2.5 Subjekti i rivlerësimit e ka shitur automjetin te shoqëria “****” sh. a., me NIPT ***, me Kontratën nr. *** rep., dhe *** kol., datë 26.4.2018, në vlerën 6,500 (gjashtë mijë e pesëqind) euro, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale, nëpërmjet transfertës bankare në “ProCredit Bank”. Në bazë të kursit të këmbimit, të monedhës euro në lekë, të Bankës së Shqipërisë datë 27.4.2018³, vlera e shitjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit ishte 838,300 (tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind) lekë.

2.6 Rezulton se çmimi i shitjes së automjetit në vlerën 838,300 lekë është me i lartë se çmimi fillestar i blerjes (700,000 lekë) i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht përdorimit të automjetit për rreth 6 vjet.

2.7 Komisioni kërkoi informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me çdo procedim penal apo kallëzim ndaj shtetasit E. D.. Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë konfirmohet⁴ se ndaj shtetasit E. D. nuk figuron i regjistruar ndonjë kallëzim apo procedim penal pranë kësaj prokurorie.

2.8 Në përfundim për këtë pasuri ka rezultuar se:

a) Subjekti i rivlerësimit, pas përdorimit të automjetit për rreth 6 vjet dhe faktit se ky automjet duhet të kishte një amortizim rreth 20% në vit⁵, llogaritur mbi çmimin e blerjes, e ka shitur me çmim më të shtrenjtë se ai i blerjes, i deklaruar prej tij.

b) Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë shpenzimet e kryera që kanë ndikuar në rritjen e vlerës së automjetit ose të provojë që çmimi i shitjes apo ai i blerjes nuk ka qenë fiktiv.

²Shihni përgjigjet e pyetësorit datë 3.7.2020.

³Sipas web-it të BSh-së kursi zyrtar i këmbimit në datën 27.4. 2018 ka qenë rreth 129 lekë (https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/)

⁴Shkresa nr. *** prot., datë 12.3.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁵Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

c) Subjekti rezulton në pamundësi financiare për blerjen e këtij automjeti dhe Komisioni nuk ka marrë në konsideratë deri në këtë moment deklarin lidhur me përdorimin e gjendjes *cash* për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2012, pasi ai nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në DPV.

2.9 Në bazë të nenit 52 subjektit i kaloi barra e provës për të shpjeguar dhe provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

2.10 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron sa vijon:

“Referimi i Komisionit, duke u bazuar në germen ‘b’, të pikës 5, të nenit 22, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar: Amortizimi i një aktivi të qëndrueshëm të trupëzuar apo të patrupëzuar amortizohet me normat e përcaktuara në këtë ligj sipas nenit 22 të sipërcituar, duke përcaktuar normat maksimale në të cilat subjekti tregtar duhet të amortizojë aktivet, jo përtej kësaj norme, por vendimet e amortizimit të aktivit merren nga ortakët, të cilët kur mbyllin pasqyrat financiare duhet të respektojnë këto norma, duke mos tejkalluar ato në varësi të politikës kontabël të ndjekur. Në rastin tonë kemi të bëjmë jo me një subjekt tregtar, por me një individ person fizik jo subjekt për të cilin referohet ligji. Duke iu referuar ligjit nr. 25/2018, ‘Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare’ kostoja e një aktivi është shuma e parave (ose ekuivalente të parave) e paguar, ose vlera e drejtë (tregu) për të blerë ose prodhuar një aktiv. Vlerë të drejtë do të kuptojmë çmimin që do të pranohej për të shitur një aktiv ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut shitës dhe blerës në datën e ndodhjes së veprimit sipas dokumentacionit provues si kontrata e shitjes ose fatura tatimore.

Dua të sqaroj Komisionin se ky automjet kur është blerë ka pasur 7 sedilje (pra, ka qenë me leje numër vendesh 6+1). Për efekt të pagimit të taksave pasi unë i paguaja si autoveturë me numër të lartë vendesh gjë të cilën nuk e kam ditur, në datën 9.3.2016, unë i kam bërë modifikimin të servisi i shtetasit Sotiraq Plasari, i licencuar për këtë lloj punimi dhe nga numër vendesh 6+1 e kam bërë me numër vendesh 4+1. Unë këtë mjet e përdorja për nevoja familjare dhe jo për transport. Ky modifikim është i ligjshëm dhe e kam deklaruar dhe kam bërë ndryshimet edhe në lejen e qarkullimit të DRSHTRR-ja Korçë.

*Detyrimisht edhe taksat për këtë mjet me këtë numër vendesh ishin më të leverdisshme për shoqërinë ‘***’. Kjo shoqëri kërkonte një automjet për transportin e punëtorëve të tij nga Korça në frigoriferin e tij rreth 1 km larg qytetit për arsye se tregton fruta perime dhe i duhej automjet me ato karakteristika që unë e kisha, dhe po ashtu ai e donte me 7 sedilje. Unë i kisha ruajtur sediljet e çmontueshme dhe administratorit të firmës duke i interesuar gjendja e mjetit, pagimi i taksave të ulëta për numrin aktual të vendeve, sasia e ulët e karburantit që konsumonte dhe fakti që kisha të ruajtura 7 sedilje, ramë dakord për çmimin 6,500 euro. Paga është bërë nëpërmjet bankës e dokumentuar dhe me faturat përkatëse.*

*Edhe pse unë nuk kam kryer një deklarin të saktë në lidhje me deklaratën periodike duke mos paraqitur ndryshimin e gjendjes *cash* për shkak se nuk kam pasur informacion, kam menduar se duke paraqitur në deklaratë në faqen e ndryshimit të pasurisë, shitjen dhe blerjen e automjeteve është nënkuptuar edhe pakësimi i gjendjes *cash*. Në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni kam dhënë shpjegimin se nga kursimet *cash* në vlerën prej 15,000 euro (të cilën e kemi analizuar më poshtë), shuma prej 700.000 lekësh është shpenzuar për blerjen e automjetit tip VW me targa *** të paraqitur në deklaratën periodike vjetore të ILDKPKI-së të vitit 2012. Kur kam deklaruar se diferenca e ngelur e gjendjes *cash* është shpenzuar në vitet 2013 - 2014 për nevoja të përditshme familjare, bëhet fjalë për diferencën e ngelur pasi është zbritur shuma 700,000 lekë për blerjen e automjetit, pra nga shuma totale e kursyer me kursin e atij viti në monedhën vendase (lekë) ka rezultuar shuma 2,070,000 dhe nga diferenca e mbetur pas blerjes së automjetit në shumën 1,370,000 lekë është deklaruar se gjendja në fund të vitit 2014 në shumën 1,000,000 lekë si gjendje *cash* të mbetur deri në atë moment (deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 26.1.2014).*

Ju, në këtë vit keni përjashtuar vlerën e shitjes së automjetit tip ‘Honda’ me vlerë 450,000 lekë sipas kontratës së shitjes të raportuar dhe deklaruar në deklaratën vjetore të ILDKPKI-së. Shpenzimet e jetesës janë llogaritur për të gjitha ditët e vitit ndërkohë, në zërin shpenzime

TIMS, Komisioni më ka llogaritur edhe kosto qëndrimi, të cilat duhet t'u zbriten shpenzimeve të jetesës në Shqipëri për ditët e qëndrimit në Greqi, pasi kemi të bëjmë me dublikim të

shpenzimeve të zërit kosto jetese, si rrjedhojë e kësaj shpenzimet e jetesës duhet të jenë më të vogla se ato të pasqyruara nga Komisioni”.

2.11 Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që në analizën financiare për vitin 2012 të merret në konsideratë pakësimi i gjendjes *cash* si burim për blerjen e automjetit në vlerën 700,000 (shtatëqind mijë) lekë, të përfshihet si e ardhur shuma 450,000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë nga shitja e automjetit me targa ***, si dhe rishikimi i shpenzimeve të jetesës duke i zbritur shpenzimet për ditët e qëndrimit jashtë Shqipërisë.

2.12 Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe provave të relatuara më lartë, vlerëson se kërkesa e subjektit për përdorimin e gjendjes *cash* që dispononte për blerjen e këtij automjeti është e logjikshme dhe e pranueshme. Trupi gjykues nuk pranon të konsiderojë këtë shpenzim si pakësim të gjendjes *cash*, duke vlerësuar se ai nuk është deklaruar në asnjë DPV dhe as në deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar si burim për blerjen e automjetit.

2.13 Lidhur me rillogaritjen e shpenzimeve të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe duke pranuar si të ardhur vetëm vlerën prej 100.000⁶ lekë nga shitja e automjetit në vitin 2012, në fund të vitit kalendarik subjekti ka rezultuar me mundësi financiare për blerjen e këtij automjeti (duke pranuar edhe faktin se në momentin e blerjes subjekti mund të përdorte gjendjen *cash* që dispononte).

2.14 Lidhur me raportin mes çmimit të blerjes dhe atij të shitjes së automjetit, referuar përdorimit të tij për 6 vjet dhe amortizimit, trupi gjykues pranon shpjegimet e subjektit, duke arsyetuar se edhe diferenca mes tyre nuk është dukshëm e ndryshme dhe vetë çmimi i shitjes bën logjikë tregtare. Lidhur me vlerën e amortizimit të referuar nga Komisioni qëndrimi ka qenë referues dhe në harmoni me logjikën ekonomike, si dhe shpjegimet e subjektit se amortizimi i referohet subjekteve tregtare duket se dalin jashtë kontekstit të vlerësimit nga Komisioni.

3. Gjendje *cash* në vlerën 1,100,000 (një milion e njëqind mijë) lekë, deklaruar në deklaratën *Vetting* nga kursimet e pagës ndër vite.

3.1 Në Deklaratën e Interesave Private para Fillimit të Detyrës datë 29.12.2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen *cash* 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.

3.2 Në DIPV-të e viteve 2009 – 2015, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi ndryshime të gjendjes *cash*. Në DIPV-në e vitit 2016 subjekti deklaroi shtim të gjendjes *cash* në shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë, nga kursimet vjetore të pagës së tij dhe të bashkëshortes.

3.3 Në vlerësim të fakteve, Komisioni ka pasqyruar në analizën financiare gjendjen *cash* të subjektit të rivlerësimit, mbështetur në të dhënat sipas deklarimeve periodike vjetore, si dhe në qëndrime të konsoliduara të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

3.4 Lidhur me burimin e krijimit të gjendjes *cash* të deklaruar para fillimit të detyrës në vitin 2009 dhe mundësitë financiare, në përgjigjet e datës 24.4.2020, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo shumë ka qenë e ardhur nga kursimet e tij gjatë viteve të punësimit, duke filluar prej vitit 1999. Subjekti shpjegon më tej se ka banuar me prindërit deri në vitin 2007, të cilët kanë pasur të ardhura të konsiderueshme, pasi babai ka qenë ish-ushtarak i lartë me të ardhura të mira e në vijimësi nuk i është dashur të kryejë shpenzime.

3.5 Referuar dokumentacionit të administruar nga sigurimet shoqërore rezultoi se prindërit (nëna dhe babai) kanë përfituar pension pleqërie prej vitit 1991 dhe babai ka përfituar edhe pension suplementar ushtarak.

3.6 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se përveç pagës si OPGJ prej vitit 2001, ka përfituar trajtim ushqimor dhe veshmbathje për periudhën 2001 – 2008 nga Ministria e Mbrojtjes si oficer aktiv pranë Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Ushtarake të Rrethit Korçë në gradën Kapiten I. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë dokumentacionin për: (a) titullimin si oficer aktiv dhe dhënie grade nga Ministria e Mbrojtjes me nr. ***, datë 5.11.2001; (b) Urdhrin nr. ***,

⁶ Për më shumë referoju pasurisë Honda Civic më poshtë në vendim.

datë 10.12.2004, të ministrit të Mbrojtjes “Për Kompensimin e Ushqimit të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; (c) Udhëzimin nr. ***, datë 1.1.2005, të ministrit të Mbrojtjes; si dhe (ç) Urdhrit nr. ***, datë 27.11.2008, të ministrit të Mbrojtjes për daljen në lirim të subjektit të rivlerësimit.

3.7 Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se ai ka pasur statusin e ushtarakut pranë Prokurorisë Ushtarake të Rrethit Korçë. Urdhri nr. ***, datë 10.12.2004, të ministrit të Mbrojtjes “Për Kompensimin e Ushqimit të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ka dalë në zbatim të VKM-së nr. 524, datë 30.7.2004, “Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Bazuar në këtë VKM, meqenëse subjekti i rivlerësimit nuk është emëruar jashtë vendbanimit të tij, në bazë të pikës 4 të saj rezulton se ka gëzuar të drejtën e kompensimit në vlerë për ushqim vetëm për vaktin e drekës për ditët efektive të punës.

3.8 Në bazë të pikës 2, të Urdhrit nr. ***, datë 10.12.2004, të ministrit të Mbrojtjes, subjekti i rivlerësimit është kompensuar në vlerë për ushqim në masën 114,98 (njëqind e katërbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë, vetëm për vaktin e drekës për ditët efektive të punës.

3.9 Subjekti i rivlerësimit ka punuar si oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Korçë duke qenë subjekt deklarimi në vitet 2003-2004, në të cilat nuk rezultojnë deklarime lidhur me kursime apo gjendje *cash* nga ana e subjektit të rivlerësimit.

3.10 Duke analizuar të ardhurat për periudhën 2005 – 2009, si dhe duke mos vendosur shpenzimet jetike për këtë periudhë, duke vlerësuar se ato janë mbuluar nga trajtimi ushqimor dhe veshmbathje, të përfituara si ushtarak⁷ (por janë vendosur shpenzime të tjera), rezulton se subjekti i rivlerësimit mund të ketë pasur mundësi të kursejë shumën prej 1,937,651 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekësh [ekuivalent i vlerës 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro⁸ të deklaruar si kursime deri në vitin 2009] para fillimit të detyrës.

Analizë 2005 - 9 dhjetor 2009	
Të ardhura të dokumentuara	3.473.925
Të ardhura nga paga e subjektit	3.473.925
Shpenzime	1.559.223
Shpenzime jetese	0
Shpenzime TIMS	1.111.702
Shpenzime qiraje	345.000
Shpenzime për lindjen e vajzës	66.501
Shpenzime interesi <i>overdraft</i>	36.021
Pasuri	(22.949)
Blerë automjet tip “Honda Civic”	100.000
Pakësime likuiditete në bankë	-122.949
Mundësia për kursime	1.937.651

3.11 Nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt deklaruar për këtë periudhë, e cila është jashtë periudhës së rivlerësimit, Komisioni ka vështirësi në llogaritjen me saktësi të mundësive të tij të kursimit. Nga hetimi rezulton se subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës 2005 – 2009, ka pasur këto karakteristika:

- në vitet 2005 - 2007 ka jetuar me prindërit dhe ka përfituar të ardhura si ushtarak;
- në vitin 2007 është martuar, me fëmijë që prej muajit dhjetor 2007;
- në vitin 2008 nuk ka më përfitime nga të ardhura si ushtarak për shkak të ndryshimit të pozicionit të punës dhe nuk jeton më me prindërit (jeton me qira 3 persona).

3.12 Nga hetimi mbi këtë pasuri, rezulton se gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit nuk përputhet me gjendjen *cash* të deklaruar përpara fillimit të

⁷(a) ka përfituar të ardhura për periudhën 1999 – 2009, në vlerën 5.667.546 lekë; (b) ka jetuar me prindërit deri në vitin 2007; (c) duket se ka përfituar trajtim ushqimor nga Ministria e Mbrojtjes si OPGJ në gradën Kapiten I prej vitit 2004.

⁸Kursi mesatar i këmbimit për periudhën 2005-2009 euro/lekë është 125.5 lekë, shuma e krijuar prej 15,000 euro konvertohet në vlerën mesatare në lekë prej 1.882.517 lekë.

detyrës (shuma 15,000 euro) dhe me deklaratimet periodike vjetore. Në vijim, subjekti i rivlerësimit duhet të provojë për Komisionin se si janë përballuar shpenzimet për familjen deri në vitin 2009, në raport edhe me mundësinë e tij për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar.

3.13 Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të shpjeguar bindshëm për Komisionin lidhur me mospërputhjet mes gjendjes *cash* dhe deklarimeve periodike vjetore në harmoni edhe me dispozitat e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare.

3.14 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar sa vijon: *“Duke iu referuar shumës prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro si kursime cash në deklaratën e ILDKPKI-së para fillimit të detyrës dhe gjendjes cash prej 1,100,000 lekë të deklaruar në deklaratën Vetting sqaroj se nga kjo shumë vlera prej 700,000 lekësh është shpenzuar në vitin 2012 për blerjen e automjetit tip VW me targa ***, të paraqitur dhe deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, plotësuar në mars të vitit 2013 dhe dorëzuar në ILDKPKI. Nuk është paraqitur si pakësim i gjendjes cash, pasi është deklaruar në rubrikën ‘ndryshimet e pasurisë dhe burimi i krijimit’ të formularit deklaratë e interesave private periodike dhe kam menduar se duke paraqitur në deklaratë në faqen e ndryshimit të pasurisë, shitjen dhe blerjen e automjeteve është nënkuptuar edhe pakësimi i gjendjes cash. Kur kam deklaruar se diferenca e ngelur është shpenzuar në vitet 2013 - 2014 për nevoja të përditshme familjare, bëhet fjalë për diferencën e ngelur pasi është zbritur shuma 700,000 lekë për blerjen e automjetit, pra nga shuma totale e kursyer me kursin e atij viti në monedhën vendase (lekë) ka rezultuar shuma 2,070,000 lekë dhe nga diferenca e mbetur pas blerjes së automjetit në shumën 1,370,000 lekë është deklaruar se gjendja në fund të 2014, në shumën 1,000,000 lekë si gjendje cash të mbetur deri në atë moment (deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 26.1.2014). Diferenca e ngelur në shumën 370,000 është shpenzuar gjatë atyre viteve”.*

3.15 Lidhur me burimin e krijimit të gjendjes *cash* prej 15,000 euro, të deklaruar në vitin 2009, subjekti shpjegon se: *“Në analizën e kryer nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë kursimet para vitit 2003, në formë depozite me interes në shumën 250,000 lekë, të cilat në përfundim të periudhës së maturimit janë tërhequr në datën 15.12.2005, në “Tirana Bank”, në shumën 291,960 lekë me nr. llogarie *** një kopje të nxjerrjes së kësaj llogarie të nënshkruar nga banka i kemi bashkëngjitur këtij raporti. Pra, vlera prej 291,960 lekësh do të sjellë ndryshime në likuiditet në analizën e mëposhtme financiare. Subjekti ka vënë në dispozicion statement-in bankar nga “Tirana Bank”, ku rezulton se është hapur depozita në vlerën 250,000 lekë, më 24.3.2003, e cila është maturuar/tërhequr më 14.12.2005 së bashku me interesat e gjeneruara në total në vlerën 291,960 lekë.*

*Sqaroj se në datën 15.4.2006, në orën 4:42 të mëngjesit, e cila korrespondon me daljen nga PKK Kapshticë kam shkuar për të vizituar manastirin e shenjtë “***”, Greqi, për një periudhë 10-ditore me rastin e Pashkës Orthodoxe dhe jam kthyer më 24.4.2006, datë e cila korrespondon me hyrjen në Shqipëri sipas sistemit TIMS. Shpenzimet e këtij qëndrimi janë vetëm shpenzime udhëtimi, pasi është fakti i njohur botërisht se kur vizitohen manastiret në *** nuk paguhet as për fjetje dhe as për akomodim. Bashkëngjitur këtij raporti do të gjeni të përkthyer dokumentin fletë e posaçme akomodimi datë 16.4.2006. Shpenzimet totale të kryera gjatë kësaj vizite ka qenë vetëm vlera 20 euro e ftesës së akomodimit dhe shpenzime transporti në shumën 70 euro vajtje - ardhje, gjithsej janë shpenzuar 90 euro. Subjekti ka përcjellë dokumentacion provues për akomodimin. Shpenzimet në sistemin TIMS për këtë periudhë ndryshojnë nga 534 euro në 178 euro.*

Në lidhje me shpenzimet e mia nga sistemi TIMS për vitin 2006, Komisioni më ka llogaritur shpenzime akomodimi për periudhën 1.5.2006 – 10.12.2006, kur ndërkohë për këtë periudhë kam qenë i fejuar dhe në të gjitha rastet kam shkuar dhe qëndruar në banesën e bashkëshortes së ardhshme në Selanik, e deklaruar në pyetësorë. Nuk kam qenë i akomoduar në shërbime hotelerie. Për periudhën 1.5.2006 – 10.12.2006 kam 31 ditë qëndrimi në Selanik, të cilën Komisioni e ka llogaritur me 50 euro shpenzime/ditë qëndrimi. Sipas ditëve të qëndrimit dhe standardit tuaj të konsoliduar, subjekti i ka llogaritur me 5 euro/ditë qëndrimi”.

3.16 Në vijim, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se duhet pranuar vlera prej 291,960 (dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekësh e maturuar/tërhequr më 14.12.2005, duke u shtuar në të ardhurat e subjektit të rivlerësimit.

3.17 Po ashtu, trupi gjykues ka vlerësuar se shpjegimet e subjekti lidhur me vizitën në manastirin e shenjtë “****”, Greqi, për një interval kohor 10-ditor me rastin e Pashkës Orthodoxe, janë bindëse duke marrë në konsideratë shpenzimet e qëndrimit ditor në vlerën 5 (pesë) euro dhe destinacionin Korçë-Selanik, duke ndryshuar në analizën financiare edhe vlerën e shpenzimeve në sistemin *TIMS* për vitin 2006 nga vlera 3,340 (tre mijë e treqind e dyzet) euro në vlerën 2,007 (dy mijë e shtatë) euro.

3.18 Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar prej tij në vitin 2009.

3.19 Lidhur me rezultatin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, e cila nuk përputhet me gjendjen *cash* të deklaruar përpara fillimit të detyrës (shuma 15,000 euro) dhe me deklaratimet periodike vjetore, trupi gjykues ka vlerësuar se dokumentacioni i dërguar në Komision nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2021, procesverbal i datës 26.1.2016 mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive, ku subjekti ka sqaruar se shuma 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, e deklaruar prej tij si gjendje *cash* në banesë, ka shërbyer për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Sharan” dhe për shpenzime familjare pa e kaluar kufirin e deklarueshëm. Në datën 31.12.2014 gjendja *cash* ka qenë rreth 1,000,000 (një milion) lekë, ndërsa në vitin 2015 ka pasur shpenzime për arsye fatkeqësie familjare (humbjen e babait në dhjetor të vitit 2015), shpenzime të cilat do t'i deklaronte në DIPV-në e vitit 2015.

3.20 Nga vlerësimi i deklaratimeve periodike vjetore nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar, ndër vite, pakësimin e gjendjes *cash* apo përdorimin e saj si burim për shpenzimet e kryera prej tij. Nga vlerësimi i DPV-së vitit 2015, dorëzuar në mars të vitit 2016, pas procesverbalit të datës 26.1.2016, mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive, rezulton se nuk deklarohet as gjendjen reale *cash* të atij viti dhe as pakësimin e gjendjes *cash* në atë vit. Në përfundim, trupi gjykues çmon se deklaratimet e subjektit janë të pasakta dhe të pamjaftueshme, si dhe nuk ka përfshirë këto vlera për të mbuluar shpenzime të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij në analizën financiare për vitet 2009 – 2016.

4. Depozitë bankare në shumën 123,558 (njëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, në emër të znj. M. S., vajza e subjektit të rivlerësimit, në “Credins Bank”, çelur më 7.11.2011. Kjo depozitë është deklaruar në seksionin e të dhënave konfidenciale në deklaratën *Vetting*, në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi burimin e krijimit të kësaj shume.

4.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPV-në e vitit 2011 hapjen e depozitës në emër të vajzës së tij në shumën 100,000 (njëqind mijë) lekë, me afat 1-vjeçar dhe interes 6.5% në vit, duke përcaktuar se kjo shumë i është dhënë dhuratë nga babai me rastin e marrjes së pensionit suplementar si ish-ushtarak.

4.2 Lidhur me këtë depozitë, subjekti i rivlerësimit në DIPV-në e vitit 2013 deklaroi shtimin me vlerë 12,400 (dymbëdhjetë mijë e katërqind) lekë, në vitin 2014 deklaroi shtimin me vlerë 4,222 (katër mijë e dyqind e njëzet e dy) lekë; në vitin 2015 deklaroi shtimin me vlerë 3,457 (tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë, në vitin 2016 deklaroi shtimin me vlerat 1,764 (një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë dhe 2,075 (dy mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

4.3 Nga dokumentacioni i dërguar në Komision nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2021, rezulton se nga subjekti i rivlerësimit është depozituar pranë këtij institucioni vendimi nr. **, datë 27.12.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me objekt “detyrimin e palës së paditur për ta trajtuar me përfitimet nga pensioni suplementar prej datës 1.1.1999 e në vazhdim ...”, e cila ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar palën e paditur DRSSH-në Korçë t'i llogarisë dhe t'i paguajë paditësit S. S. pension suplementar pleqërie nga data 1.1.2006 deri në datën 30.6.2009 ...”. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. **, datë

5.4.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

4.4 Referuar dokumentacionit të administruar nga sigurimet shoqërore ka rezultuar se pagesat përkatëse janë ekzekutuar në vijim, mbështetur në vendimin nr. ***, datë 5.4.2012, të Gjykatës së Apelit Korçë.

4.5 Sa më sipër, rezulton se depozita bankare në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit është hapur një vit më parë se babai i subjektit të rivlerësimit të përfitonte nga DRSSH-ja Korçë të ardhurat e pensionit suplementar të pleqërisë.

4.6 Në përfundim, lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e depozitës rezulton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit nuk përputhet me burimin e krijimit të depozitës pasi periudha e çeljes së depozitës bankare (datë 7.11.2011) është përpara periudhës së përfitimit të shumave nga pensioni suplementar i babai të tij (viti 2012). Në analizën financiare të Komisionit nuk është reflektuar kjo shumë si balancë negative për faktin se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur potencial të ardhurash për dhurimin e shumës 100,000 (njëqind mijë) lekë në vitin 2011.

4.7 Lidhur me mosdeklarimin e burimit të kësaj shume në deklaratën *Vetting* subjekti shpjegon se: *“Nuk e kam deklaruar burimin në deklaratën Vetting duke menduar se ka qenë e deklaruar më parë dhe në deklaratën periodike vjetore. Në deklaratën e interesave periodike vjetore për vitin 2011, dorëzuar më 7.3.2012, në seksionin e të dhënave konfidenciale të deklaratës është deklaruar ‘dhuratë në mjete monetare me rastin e marrjes së pensionit suplementar si ish-ushtarak, babai S. S. në shumën 100,000 lekë’”*.

4.7.1 Lidhur me burimin e krijimit të depozitës pasi periudha e çeljes së depozitës bankare (datë 7.11.2011) është përpara periudhës së përfitimit të shumave nga pensioni suplementar i babai të tij (viti 2012), subjekti sqaron se: *“... deklarimi ka qenë i sigurtë dhe në përputhje me faktet (kohën) kur ka ndodhur ngjarja. Babai im për arsye se ka qenë ish-ushtarak ka përfituar pension suplementar sipas ligjit në fuqi. Pensioni suplementar i ka filluar të llogaritet që nga data 1.7.2009 e në vazhdim derisa ndërroi jetë. Vendimi i Komisionit për caktim pensioni suplementar mban datën 8.10.2011. Sipas përlllogaritjeve, për periudhën 1.7.2009 – 30.6.2011, i takonte të merrte shumën 242,950 lekë. Mbjaj mend që këtë shumë e ka tërhequr njëherësh të gjithën pasi doli vendimi, pra në muajin tetor të vitit 2011. Nga kjo shumë mua më ka dhënë për vajzën time M. (mbesën e tij) shumën 100,000 lekë, të cilën unë e kam depozituar në bankë në llogari të vajzës, depozitë me afat siç e kam deklaruar. PAGESA E PENSIONIT SUPLEMENTAR PËR LLOGARI TË VENDIMIT TË GJYQIT (PËR NJOHJEN E PERIUDHËS 1.1.2006 – 30.6.2009) është marrë më vonë me sa mbaj mend në vitin 2012 dhe është tërhequr njëherësh nga babai. Nuk ka lidhje me shumën e pensionit suplementar që ka marrë në fillim, pra në tetor të vitit 2011. Për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të mia ju paraqes vërtetim të sigurimeve shoqërore Korçë me nr. *** prot., datë 25.5.2021, për pensionin suplementar të babait tim ku janë detajuar periudhat dhe masa e përfitimit sipas viteve”*.

4.7.2 Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë pranë Komisionit shkresën nr. ***, datë 25.5.2021, të lëshuar nga ISSH-ja Korçë, ku informohet se përfitimi suplementar me nr. *** me vendim caktim pensioni datë 8.10.2011, ka datë fillimi 1.7.2009, me masë mujore 9,925 (nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekë, nga e cila shtetasi S. S. ka përfituar shumën 242,952 (dyqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) lekë për periudhën 1.7.2009 – 30.6.2011. Në vendim për rishqyrtimin e pensionit nr. ***, datë 12.7.2012 rishqyrtohet përfitimi dhe data e fillimit të pensionit sipas vendimit datë 27.12.2011 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Korçë, ndryshon. Ky përfitim fillon më 1.1.2006 dhe i jepen diferencat për periudhën 1.1.2006 – 30.6.2009, në shumën 309,908 (treqind e nëntë mijë e nëntëqind e tetë) lekë.

4.8 Trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit janë të mjaftueshme dhe nuk konstaton problematika lidhur me këtë pasuri.

17. GJETJE TË TJERA

1. Automjet tip “Honda Civic”, me targa ***, viti i prodhimit 1993, blerë me Kontratën nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 3.8.2006, në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën e Interesave Private para fillimit të detyrës, datë

29.12.2009. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën e Interesave Private para fillimit të detyrës, nuk deklaroi burimin e të ardhurave të përdorura për blerjen e automjetit.

1.1 Blerja e automjetit është deklaruar fillimisht në Deklaratën e Interesave Private para Fillimit të Detyrës, në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë dhe në DIPV-në e vitit 2012 është deklaruar shitja në vlerën 450,000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

1.2 Lidhur me këtë pasuri, DRSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 7.2.2020, konfirmon për Komisionin blerjen dhe shitjen e automjetit nga subjekti i rivlerësimit, duke vënë në dispozicion edhe dosjen e plotë të tij. Sipas dokumentacionit rezultoi se:

a) Ky automjet ka hyrë në territorin e Shqipërisë nga pika doganore “Tre Urat” në datën 3.8.2006, i pajisur me targa ***, nga shtetasi E. T., i cili e ka blerë me Kontratën e Shitjes në vlerën 800 (tetëqind) euro, në datën 23.12.2005. Certifikata e Pronësisë e mëparshme e automjetit tregon se vendi i origjinës së tij ka qenë Gjermania.

b) Sipas Deklaratës Doganore datë 4.8.2006, automjeti është deklaruar në vlerën 800 (tetëqind) euro, vlera statistikore rezultoi 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe totali i shpenzimeve për zhdoganim të paguara nga shtetasi E. T., sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 4.8.2006, është 164,791 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë.

c) Subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin nga shtetasi E. T. me Kontratën nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 3.8.2006, në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, e cila është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

1.3 Bazuar në analizën financiare të datës 3.8.2006, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka të ardhura me burim të ligjshëm për të blerë këtë pasuri sipas çmimit të deklaruar.

1.4 Subjekti i rivlerësimit e ka shitur automjetin të shtetasi M. D., me Kontratën nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 13.7.2012, në vlerën 450,000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.5 Komisioni konstaton se pavarësisht përdorimit për rreth 6 vjet të automjetit, subjekti i rivlerësimit e ka shitur atë disa herë më shtrenjtë. Mbështetur në germën “b”, të pikës 5, të nenit 22, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, automjetet amortizohen në vlerën 20 % në vit.

1.6 Në përfundim, për këtë pasuri, subjekti duhet të shpjegojë për Komisionin shpenzimet e kryera që kanë ndikuar në rritjen e vlerës së automjetit ose të provojë se çmimi i deklaruar për blerjen apo shitjen e tij nuk është fiktiv.

1.7 Në bazë të nenit 52 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

1.8 Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se ashtu siç theksohet edhe nga SKK5 pavarësisht kushteve dhe amortizimit, vlera e njohjes së një aktivi është vlera e drejtë ajo që pranohet nga shitësi dhe nga blerësi në momentin që ndodh transaksioni, pavarësisht vlerës së tij të blerjes apo vlerës së tij të mbetur nga periudha e blerjes dhe se ka deklaruar se ka kryer mirëmbajtjen e vazhduar të automjetit ndër vite.

1.9 Duke vlerësuar marrëdhënien miqësore të subjektit me shitësin e automjetit dhe vlerën e automjetit në momentin e shitjes prej 800 (tetëqind) euro, Komisioni vlerëson se çmimi i blerjes është real.

1.10 Bazuar në sistemin *TIMS* rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar jashtë Shqipërisë me këtë automjet më shumë se 100 herë (mesatarisht 16 herë në vit) deri në momentin që e ka shitur. Shpjegimet e tij lidhur me shërbimet e mirëmbajtjes nuk janë vlerësuar të mjaftueshme për të justifikuar vlerën e shitjes së automjetit 3 herë më shumë, pas 6 vjetëve përdorim, të tij. Komisioni vlerëson se nuk ka asnjë logjikë ekonomike apo tregtare që kësaj pasurie t’i rritet vlera duke pranuar vlerën e shitjes të jetë e barabartë me atë të blerjes, e duke llogaritur në analizën financiare shumën 100,000 (njëqind mijë) lekë si të ardhur të ligjshme.

2 Kursime cash në vlerën 4,440,000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë – deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Interesave Private para fillimit të detyrës datë 29.12.2009, të disponuara nga prindërit e saj, nga të ardhurat nga qiraja

e apartamentit të banimit në rrugën “***”, Durrës, lëshuar me qira që në vitin 1992. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshortja) nuk kanë deklaruar lidhur me disponimin e kësaj shume në deklaratën *Vetting*.

2.1 Në deklaratimet periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësime lidhur me shumën 4,440,000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë dhe as në deklaratën *Vetting* nuk deklaroi veprime.

2.2 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur shprehet se nga shuma 4,400,000 (katër milionë e katërqind mijë) lekë deri në fund të vitit 2014 nga bashkëshortja është shpenzuar shuma prej 1,000,000 (një milion) lekësh për shkak të udhëtimeve të prindërit në Greqi, si edhe shpenzime të tjera personale të saj. Shuma e mbetur prej 3,400,000 (tre milionë e katërqind mijë) lekësh është konvertuar në euro dhe i është dhënë prindërve të bashkëshortes duke qenë se ishin të ardhura që kanë rrjedhur nga prona e tyre për përballimin e nevojave të tyre ekonomike. Subjekti deklaroi se kjo shumë nuk i është dhuruar bashkëshortes dhe as nuk i është falur asaj ndonjëherë. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se vendimmarrjen për menaxhimin e gjendjes *cash* të këtyre shumave e ka pasur bashkëshortja e tij, pasi ishin kursime nga të ardhurat që buronin nga familja e saj dhe nuk ka ndërhyrë në këtë marrëdhënie.

2.3 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur⁹ nga Komisioni lidhur me administrimin e apartamentit të dhënë me qira, arkëtimin e të ardhurave nga qiramarrësit dhe të ardhurat vjetore nga qiraja, shprehet se: *“Siç më ka thënë bashkëshortja dhe babai i saj, këtë pronë e kanë administruar pronarët e ligjshëm të saj, V. dhe R. K.. Të ardhurat i ka arkëtuar babai i bashkëshortes gjatë ardhjeve të tij të here pas hershme në Durrës, ose edhe nëna e bashkëshortes kur ka ardhur vetëm ajo në Durrës. Siç më ka thënë bashkëshortja, në raste të rralla të pamundësisë për të ardhur në Shqipëri, të ardhurat janë arkëtuar nga gjyshja e bashkëshortes sime e quajtur E. F., e cila ka ndërruar jetë në vitin 2010 me sa mbaj mend. Me sa më ka thënë vjehri im të ardhurat kanë variuar nga 250,000 deri 350,000 lekë në vit”*.

2.3.1 Lidhur me disponimin e shumës prej 4,440,000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekësh, subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk është kaluar jashtë shtetit, por ka qenë e ruajtur në banesën e gjyshes së bashkëshortes së tij, me banim në Durrës.

2.4 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur¹⁰ nga Komisioni lidhur me këmbimin në euro të shumës 3,400,000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë që u është kthyer prindërve të bashkëshortes dhe momentin e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë të kësaj shume, shprehet se: *“Me sa mbaj mend ka qenë viti 2014, periudhë kur vjehrra ka ardhur në Korçë. Me sa më ka thënë bashkëshortja, një nga ditët që vjehrra ka qëndruar në Korçë kanë shkuar të dyja për të kryer këmbimin në një nga këmbimoret e qytetit. Nuk jam interesuar për hollësi sepse ka qenë vendimmarrje e tyre dhe shumë e krijuar nga pasuria e tyre. Nga biseda me vjehrrën më ka thënë se nuk ka marrë ndonjë dokument apo faturë për këmbimin e kryer. Siç më ka thënë vjehri dhe vjehrra, të cilët na kanë vizituar shpesh herë, shumat në kufi i kanë kaluar vetë ata, gjatë kalimeve të tyre, jo të gjithën njëherësh, si për arsye sigurie, pra për të mos qarkulluar me sasi të mëdha mjetesh monetare, ashtu edhe për të respektuar rregullat e kalimit në kufi, pra duke mos e kaluar limitin e detyrueshëm për t’u deklaruar”*.

2.5 Nga dokumentacioni rezultoi Certifikata e Pronësisë së apartamentit me sip. 84.33 m², në qytetin e Durrësit, përfituar nga privatizimi, në emër të prindërve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

2.6 Nga Komisioni është kërkuar informacion nga Ujësjellës Kanalizime Durrës dhe OSHEE-ja lidhur me konsumimin e këtyre shërbimeve. Nga UKD-ja rezultoi se shtetasi V. K. nuk ka pasur konsumim deri në vitet 2016, tarifa ka qenë e përbërë nga taksa, në vitin 2017 fillon faturim për periudha të caktuara, kryesisht maj-gusht. OSHEE-ja, për shtetasit V. dhe R. K., përcjell se nuk rezultojnë të jenë abonentë dhe të kenë kontratë të furnizimit me energji elektrike.

⁹Shihni përgjigjen nr. 2, në pyetësin datë 16.4.2021.

¹⁰Shihni përgjigjen nr. 3, në pyetësin datë 16.4.2021.

2.7 Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton ndonjë provë që prindërit e bashkëshortes të kenë përfituar të ardhura nga dhënia me qira e apartamentit në qytetin e Durrësit, apo që për këto të ardhura të jenë paguar detyrimet tatimore. Nga subjekti i rivlerësimit nuk është depozituar ndonjë dokument që të provojë dhënien me qira të këtij apartamenti dhe periudhat përkatëse të dhënies me qira, si dhe shumat përkatëse të përfituara.

2.8 Nga hetimi ka rezultuar se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar mundësinë e krijimit të këtyre të ardhurave në vlerën 4.440.000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë me burime të ligjshme nga personi i lidhur, bashkëshortja e tij.
- b) Mosdeklarim nga ana e subjektit në deklaratat periodike vjetore lidhur me pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2009 nga personi i lidhur, si dhe mosdeklarim në deklaratën *Vetting* mbi shumën, përdorimin e tyre për të mbuluar shpenzime të familjes, si dhe tjetërsimin/kthimin e pretenduar të shumës nga subjekti. Sa më sipër, trupi gjykues ngre dyshime mbi fiktivitetin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me deklarimin e tyre gjatë të gjithë viteve.
- c) Në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9049/2003 subjekti rivlerësimit ka detyrimin për deklarim të pasurive në pronësi apo përdorim të tij apo personave të lidhur me të dhe duket se subjekti i rivlerësimit Gentian Stoja nuk ka përmbushur detyrimet përkatëse në ushtrim të funksionit të tij si prokuror.

2.8.1 Në bazë të nenit 52 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

2.9 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se:

*“Bazuar në kthim përgjigjen nr. *** prot., datë 18.5.2021, të OSSHE-së provohet se sipas kërimit në sistemin e menaxhimit të kontratave me emrin V. K. rezulton një kontratë furnizimi me energji elektrike familjare për apartament banimi. Kontrata është lidhur në datën 20.5.1998. Matësi i kontratës së mësipërme është vendosur në kohën kur është lidhur kontrata dhe në datën 23.9.2015 është bërë vulosje dhe sistemim matësi. Abonenti V. K. është furnizuar në mënyrë të vazhdueshme me energji elektrike. Kontrata nuk rezulton debitore ndaj OSHEE-së sh. a.*

Në lidhje me krijimin e shumës 4,440,000 lekë, fillimisht, sqaroj se me sa më ka thënë bashkëshortja, kjo shumë është krijuar nga familja e bashkëshortes sime kohë përpara se unë ta njihja dhe të lidhja martesë me atë dhe kjo shumë nuk ka të bëjë aspak me të ardhurat pas dhe gjatë martesës sime. Unë kam lidhur martesë me shtetasen M. K. në korrik të vitit 2007. Bashkëshortja më ka thënë se kjo shumë ka qenë disponuar nga bashkëshortja ime ashtu edhe siç është deklaruar në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës. Kjo shumë nuk i është dhuruar bashkëshortes sime dhe as nuk i është falur asaj. Arkëtimin e kësaj shume me sa më ka thënë bashkëshortja, e ka kryer babai i saj gjatë vajtjeve të tij të herë pas herëshme në Durrës ose edhe nga nëna e bashkëshortes kur ka shkuar vetëm ajo.

*Lidhur me mosdeklarimin e kësaj shume në deklaratën *Vetting*, deklaroj se kjo shumë është kthyer në vitin 2014, fakt ky i deklaruar edhe tek inspektori përkatës i ILDKPKI-së, datë 26.1.2016. Duke e konsideruar të ezauruar si sqarim dhe deklarim përpara organit kompetent ILDKPKI-së dhe faktin se në vitin 2014 bashkëshortja e kishte kthyer këtë shumë nuk është konsideruar nga ana ime si detyrimin për ta deklaruar sepse ka qenë një marrëdhënie e mbyllur në vitin 2014. Po ashtu, bashkëshortja ime nuk ka krijuar ndonjë pasuri të deklarueshme në *Vetting*, ku kjo shumë të jetë përdorur si bazë për krijimin e pasurisë. Ato përveçse janë deklaruar pranë ILDKPKI-së nuk është kryer në ndonjë investim, i cili do të kishte si burim financimi këto shuma. Deklarimi i tyre në këtë deklaratë nuk ka qenë për të fshehur, por për faktin se unë kam qenë subjekt i ligjit për deklarimin e pasurive. Unë nuk kam ndërhyrë në marrëdhënien e tyre para martesës dhe kjo nuk mund të më penalizojë mua në procesin ndaj meje. Për sa kohë prindërit e bashkëshortes kanë pasur mundësi financiare për t’ia lënë në disponim këto shuma, por edhe për t’i dhënë të drejtën t’i përdorë, mua më përjashtojnë nga detyrimi ligjor për të justifikuar barrën e provës, kur në një kohë ata e kanë*

shprehur vullnetin e tyre edhe në deklaratat, dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2016, duke mbajtur edhe përgjegjësi ligjore për deklarim të rremë”.

2.10 Në përfundim, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit mbeten deklarative dhe të paprovuara në ndonjë formë ligjore apo nëpërmjet deklarimeve periodike vjetore. Po ashtu, trupi gjykues çmon se mbetet e paprovuar mundësia për krijimin e shumës 4,440,000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë me burim nga qiradhënia e një pasurie, e cila vlerësohet modeste, jo në zonë bregdetare (ndodhet në qytet) pa konsumime të energjisë elektrike apo ujësjellësit dhe pa ndonjë dokument provues se marrëdhënia e qiradhënies ka ekzistuar. Edhe nëse merret në konsideratë një qiradhënie sezonale, sipas pretendimeve të subjektit, përsëri vlera prej 4,440,000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekësh konsiderohet në çmim të trupit gjykues, e lartë dhe e pamundur për t’u krijuar, referuar dokumentacionit të administruar dhe provave të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit që kjo trupë ka administruar.

2.11 Në këto kushte, trupi gjykues çmon se personi i lidhur me subjektin ka bërë deklarim të rremë në deklaratën periodike vjetore para fillimit të detyrës, të plotësuar nga subjekti i rivlerësimit dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar me vërtetësi pasuritë dhe të ardhurat e tij në deklaratimet periodike vjetore, si dhe në deklaratën *Vetting*. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, pasi ka fshehur në deklaratën *Vetting* të dhëna lidhur me këtë pasuri.

3 Të ardhura cash në vlerën 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, në formë dhurate – deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Interesave Private para fillimit të detyrës datë 29.12.2009, të dhuruara nga prindërit dhe motrat me rastin e martesës.

3.1 Shuma e deklaruar si gjendje *cash* në vitin 2009 nuk gjen më pasqyrim në asnjë prej DIPV-ve apo në deklaratën *Vetting*.

3.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 11.7.2020, deklaron se shuma *cash* prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro është sjellë nga bashkëshortja në formë paje, me qëllim blerjen e një apartamenti si çift i ri me rastin e martesës në vitin 2007. Në vijim, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në vitin 2011 prindërit e tij i dhuruan apartamentin në pronësinë e tyre dhe ata u kthyen për të jetuar në këtë banesë së bashku me prindërit dhe, për këtë shumë, bashkëshortja dhe motrat e saj kanë vendosur ta kalojnë pa të drejtë kthimi prindërve të bashkëshortes. Vendimmarrjen për menaxhimin e kalimit të kësaj shume e ka pasur bashkëshortja dhe motrat e saj, pasi kjo shumë ishte e ardhur që buronte nga familja e saj përpara martesë dhe ai nuk ka ndërhyrë në këtë marrëdhënie.

3.3 Referuar deklaratave të interesave private periodike vjetore rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar kthimin e kësaj shume prindërve të bashkëshortes apo pakësimin e gjendjes *cash*, ndër vite, dhe as në deklaratën *Vetting*.

3.4 Nga dokumentacioni i dërguar në Komision nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2021, rezulton se nga subjekti i rivlerësimit është depozituar deklarata e datës 30.1.2016 e babait të bashkëshortes, i cili deklaron se së bashku me dy vajzat e tij i kanë dhuruar në formën e pajës për blerjen e një apartamenti në qytetin e Korçës, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit shumën prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro (18,000 euro prindërit dhe nga 16,000 euro secila nga motrat). Gjithashtu, janë depozituar edhe deklaratat e datës 3.2.2016 të motrave dhe bashkëshortëve respektivë të shtetasës M. K., të cilët deklarojnë se i kanë dhuruar secila shumën prej 16,000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) euro në formën e pajës për blerjen e një apartamenti. Në deklaratë babai i bashkëshortes së subjektit shprehet se subjekti ia ka kthyer atij mbrapsht të gjithë shumën *cash* prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, pra edhe pjesën e dhuruar nga motrat por nuk shprehet mënyra se si është dërguar në Greqi kjo shumë.

3.5 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur¹¹ nga Komisioni lidhur me momentin e dhurimit të shumave respektive, hyrjen e këtyre shumave në territorin e Republikës së Shqipërisë, kthimin e shumës 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro te prindërit e bashkëshortes dhe kur ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, shprehet se: “*Shumat respektive janë dhuruar me rastin e martesës, deklaruar nga bashkëshortja ime në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës. Me*

¹¹Shihni përgjigjen nr. 5, në pyetësin datë 16.4.2021.

sa mbaj mend dhe me sa më kanë thënë prindërit e bashkëshortes, para martesës kanë ardhur disa herë nga Greqia për përgatitjet e dasmës, ndërsa motrat së bashku me familjarët e tyre kanë ardhur nga Italia me familjet e tyre të përbëra prej katër dhe pesë pjesëtarësh, çka mbulonte kalimin e këtyre shumave në doganë në përputhje me ligjin. Me sa mbaj mend, shuma 50,000 euro iu është kthyer në periudhën e vitit 2013. Vjehri dhe vjehrra kanë qarkulluar shpesh nga Greqia në Shqipëri dhe anasjelltas dhe, për këtë arsye, shumat në kufi i kanë kaluar vetë ata gjatë kalimeve të tyre, jo të gjithën njëherësh, si për arsye sigurie, pra për të mos qarkulluar me sasi të mëdha mjetesh monetare, ashtu edhe për të respektuar rregullat e kalimit në kufi, pra duke mos e kaluar limitin e detyrueshëm për t'u deklaruar”.

3.6 Nga verifikimi në sistemin TIMS të hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë të prindërve dhe motrave të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, rezulton se prindërit kanë udhëtuar shpesh herë nga Greqia për në Shqipëri dhe anasjelltas. Motrat dhe bashkëshortët e tyre kanë udhëtuar nga Italia për në Shqipëri në periudhën qershor – korrik 2007, kohë kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është martuar.

3.7 Në datën 10.7.2020, nga subjekti i rivlerësimit janë dërguar në Komision dokumente lidhur me burimin e të ardhurave të prindërve të bashkëshortes në Greqi, si dhe të motrave dhe bashkëshortëve të tyre, në Itali, si vijon:

- a) akt rakordimi i tatimit mbi të ardhurat e personave fizikë, lëshuar nga Ministria e Financave të Republikës së Greqisë, për periudhën 1999 – 2018, në gjuhën greke, me vulë apostile dhe i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe;
- b) deklarata e llogarisë së sigurimeve shoqërore, lëshuar nga INPS Itali, për shtetasit I. J., D. K. dhe E. K., në gjuhën italiane, të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe, por pa vulën apostile.

3.8 Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga subjekti për të ardhurat e prindërve të saj në Greqi, rezulton se në vitin 2007 ata kanë mundësi financiare për dhurim të shumës 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë) euro vajzës së tyre.

3.9 Nuk ka ndonjë dokument që të provojë si janë sjellë në Shqipëri këto fonde dhe si është kthyer në Greqi shuma e dhuruar prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro duke mos u provuar në ndonjë mënyrë pretendimi i subjektit të rivlerësimit. Po ashtu ai nuk gjen pasqyrim as në deklaratimet periodike vjetore.

Analizë 1999 – 2006	Vlera në euro
Të ardhura V. K. dh R. K.	102.125
Shpenzime jetese 3 persona ¹²	59.773
Dhuratë vajzës M. K.	18.000
Rezultati	24.351

3.10 Bazuar në deklaratën e llogarisë së sigurimeve shoqërore të dorëzuara për të dy bashkëshortët e motrave të bashkëshortes së subjektit, rezulton se të ardhurat e tyre familjare janë më të ulëta se shpenzimet jetike të jetës, duke sjellë në pamundësi financiare për të bërë dhuratë në vlerën 32,000 (tridhjetë e dy mijë) euro për kumatën e tyre në vitin 2007.

Analiza 1996 - 2006	euro
Të ardhura	124.489
I. J.	62.742
D. K.	61.747
Shpenzimet	183.555
Shpenzime jetese ¹³	151.555
Dhuratë për M. K.	32.000
Rezultati	-59.066

3.11 Në përfundim rezulton se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar mundësinë e krijimit të këtyre të ardhurave prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, të përfituara nga bashkëshortja e tij si dhuratë. Deklarimet e

¹²<http://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>

¹³Shpenzimet e jetesës janë bazuar në të dhënat e Eurostat për Italinë në vitet 1996-2006 [Eurostat - Data Explorer \(europa.eu\)](http://ec.europa.eu/eurostat/tgm/table.do?tab=table). Janë marrë në konsideratë shpenzimet vetëm për 4 persona (pa përfshirë fëmijë) dhe në vitet që nuk kanë pasur të ardhura të deklaruara nuk janë marrë në konsideratë shpenzime jetese.

- subjektit, gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, nuk gjejnë përputhje me ndonjë dokumentacion ligjor provues.
- b) Mosdeklarimet nga ana e subjektit në deklaratat periodike vjetore lidhur me pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2009, si dhe mosdeklarimi i veprimeve të kryera me këtë shumë në deklaratën *Vetting* duket se kanë pasur për qëllim fshehjen e kësaj pasurie apo se deklarimet e subjektit në vitin 2009 kanë qenë fiktive.
 - c) Në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për deklarim të pasurive në pronësi apo përdorim të tij apo personave të lidhur me të dhe duket se subjekti i rivlerësimit Gentian Stoja nuk ka përmbushur detyrimet përkatëse në ushtrim të funksionit të tij si prokuror.

3.12 Në bazë të nenit 52 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

3.12.1 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Në lidhje me burimin e këtyre shumave ju kemi dërguar dokumentacionin të firmosur dhe vulosur nga autoritetet përkatëse të huaja greke dhe italiane në lidhje me burimin e krijimit të këtyre të ardhurave për periudhën e dhuruar. Sqaroj se prindërit e bashkëshortes, së bashku me bashkëshorten time, kanë emigruar në Greqi që në datën 1.9.1992, vërtetuar kjo me kopje të dokumenteve ligjore greke dërguar më parë pranë KPK-së. Po ashtu, kam siguruar edhe deklaratat e të ardhurave personale të tyre ndër vitet në emigrim. Prindërit e bashkëshortes i kanë dhuruar shumën 18,000 euro, ndërsa motrat respektivisht 16,000 euro. Deklaratat respektive të nënshkruara prej prindërve dhe motrave të bashkëshortes janë dorëzuar nga unë në ILDKPKI në vitin 2016, pranë inspektoreve përkatëse.*

*Lidhur me mosdeklarimin e kësaj shume në deklaratën *Vetting* deklaroj se kjo shumë kthyer në vitin 2013, i deklaruar ky fakt edhe tek inspektori përkatës i ILDKPKI-së datë 26.1.2016. Duke e konsideruar të ezauruar si sqarim dhe deklarim përpara organit kompetent ILDKPKI dhe faktin se në vitin 2013 bashkëshortja e kishte kthyer këtë shumë nuk është konsideruar nga ana ime si detyrimin për ta deklaruar sepse ka qenë një marrëdhënie e mbyllur në vitin 2013. Po ashtu, bashkëshortja ime nuk ka krijuar ndonjë pasuri të deklarueshme në *Vetting*, ku kjo shumë të jetë përdorur si bazë për krijimin e pasurisë. Ato përveçse janë deklaruar pranë ILDKPKI-së nuk është kryer në ndonjë investim, i cili do të kishte si burim financimi këto shuma”.*

3.13 Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të dhuruesve dhe mundësitë e tyre financiare për të dhuruar shumën e plotë prej 50,000 euro. Pretendimet e subjektit se këto shuma të dhuruara janë kthyer, mbeten deklarative dhe në vlerësim të trupit gjykues mbeten të paprovuara. Argumentet e pretenduara nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit se nuk kanë shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie dhe fakti se kthimi i tyre nuk gjen pasqyrim në asnjë prej deklarimeve periodike vjetore, në vlerësim, trupi gjykues i bën deklarimet e personit të lidhur me subjektin të rreme dhe se subjekti i rivlerësimit ka fshehur të dhëna lidhur me këtë pasuri në deklaratën *Vetting*.

3.14 Subjekti i rivlerësimit ka dhënë si argument se shuma prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro i ishte dhuruar atyre për blerjen e një shtëpie, e cila nuk ju nevojitej më atyre, prandaj dhe vlerat ishin kthyer mbrapsht. Jo vetëm që nuk ka asnjë dokument ligjor provues mbi kthimin e këtyre shumave, por dhe arsyetimi se shtëpi nuk do të blinin nuk duket bindës, pasi subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë një pasuri (truall+shtëpi) në vitin 2019, ku në vijim kanë ndërtuar një shtëpi banimi private (vilë)¹⁴.

3.15 Trupi gjykues çmon se mbetet e paprovuar mundësia për krijimin e gjithë shumës prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, në plotësim të kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe mbetet deklarativ posedimi i kësaj vlere nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, si dhe mbetet i paprovuar kthimi i këtyre shumave te dhuruesit.

¹⁴Nuk është bërë pjesë e rivlerësimit pasi nuk është pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting*.

3.16 Në këto kushte, trupi gjykues çmon se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në deklaratën periodike vjetore para fillimit të detyrës, të plotësuar nga subjekti, dhe se ky i fundit nuk ka treguar me vërtetësi pasuritë dhe të ardhurat e tij në deklaramet periodike vjetore, si dhe në deklaratën *Vetting*. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e gurmës “c”, të pikës 5, të nenit 33, pasi ka fshehur në deklaratën *Vetting* të dhëna lidhur me këtë pasuri.

4 Të ardhura në shumën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë – deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në DIPV-të e vitit 2010 – 2013, nga qiraja e apartamentit në Durrës. Këto të ardhura nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja në deklaratën *Vetting*.

4.1 Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja e apartamentit në Durrës, gjatë sezonit të plazhit, si vijon: në vitin 2010 shumën 250,000 (dyqind pesëdhjetë mijë) lekë; në vitin 2011 shumën 250,000 (dyqind pesëdhjetë mijë) lekë; në vitin 2012 shumën 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë; në vitin 2013 shumën 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

4.2 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur¹⁵ nga Komisioni lidhur me lidhur me arkëtimin e të ardhurave nga qiramarrësit për periudhën 2010 – 2013 dhe përdorimin e kësaj shume, sqaron se: *“Siç më ka thënë bashkëshortja, arkëtimin e kësaj shume e ka kryer babai i bashkëshortes gjatë vajtjeve të tij të planifikuara në Durrës, ose edhe nëna e bashkëshortes kur ka ardhur vetëm. Shumat përkatëse në lekë janë përdorur nga bashkëshortja ime sipas viteve kalendarike që janë marrë dhe është deklaruar në formë të singertë në formularët periodikë vjetorë pranë ILDKPKI-së, për periudhën e deklarimit. Janë përdorur për nevoja personale të jetesës së përditshme dhe për udhëtimet e saj në Greqi për të vizituar prindërit në Selanik”*.

4.3 Nga Komisioni është kërkuar informacion nga Ujësjellës Kanalizime Durrës dhe nga OSHEE-ja lidhur me konsumimin e këtyre shërbimeve. Nga përgjigjet e ardhura nga UKD-ja rezulton se shtetasi V. K. nuk ka pasur konsumim deri në vitin 2016, tarifa ka qenë e përbërë nga taksa dhe në vitin 2017 fillon faturim për periudha të caktuara kryesisht maj-gusht. Sipas OSHEE-së, shtetasit V. dhe R. K. nuk rezultojnë të jenë abonentë dhe të kenë kontratë të furnizimit me energji elektrike.

4.4 Subjektit të rivlerësimit i është kërkuar nga Komisioni¹⁶ që të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor të përfitimit të tyre dhe shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit për tatimin mbi të ardhurat.

4.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e datës 24.4.2020, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat nga qiraja e apartamentit për periudhën 2010 – 2013, sqaron se përfituesi i drejtpërdrejtë i këtyre të ardhurave ka qenë babai i bashkëshortes dhe jo bashkëshortja e tij, si dhe ka qenë detyrimi i tij për të paguar tatimin mbi të ardhurat. Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar në Komision dokumentacion që provon përfitimin e të ardhurave nga prindërit e bashkëshortes nga dhënia me qira e apartamentit në qytetin e Durrësit apo që për këto të ardhura të jenë paguar detyrimet tatimore. Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar ndonjë dokument që të provojë dhënien me qira të këtij apartamenti dhe periudhat përkatëse të dhënies me qira apo shumat përkatëse të përfituara.

4.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 24.4.2020, deklaroi se këto shuma janë të deklaruara në ILDKPKI dhe janë shpenzuar për nevoja personale të bashkëshortes dhe udhëtimeve të saj për të takuar prindërit në Greqi, sipas periudhave të përfituara ku shuma e këtyre shpenzimeve nuk e ka kaluar kufirin e detyrimit ligjor për të deklaruar si subjekt.

4.7 Në përfundim, subjekti i rivlerësimit duhet të provojë përfitimin e këtyre të ardhurave dhe burimin e ligjshëm të tyre sipas përcaktimeve në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Deri në këtë moment ato nuk janë llogaritur në analizën financiare të Komisionit për vitet 2009 – 2016, si e ardhur.

¹⁵Shihni përgjigjen nr. 4, në pyetësorin datë 16.4.2021.

¹⁶Shihni përgjigjen nr. 2, të pyetësorit të datës 2.3.2020.

4.8 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: “*Sqaroj Komisionin se gjatë periudhës 2010 – 2013, babai i bashkëshortes e lëshonte me qira apartamentin e tij gjatë sezonit të plazhit në shtetas kryesisht maqedonas dhe të huaj me të cilët ishte lidhur vetë. Shumat përkatëse ia ka dhënë bashkëshortes sime për arsye se ishte e papunë dhe janë përdorur nga bashkëshortja ime sipas viteve kalendarike që janë marrë dhe është deklaruar në formë të singertë në formularët periodikë vjetorë pranë ILDKPKI-së, për periudhën e deklarimit. Nuk janë deklaruar në deklaratën Vetting duke e konsideruar të ezauruar si sqarim edhe faktin se nuk është konsideruar nga ana ime si detyrimin për ta deklaruar sepse ka qenë një marrëdhënie e mbyllur në vitin 2013. Po ashtu, bashkëshortja ime nuk ka krijuar ndonjë pasuri të deklarueshme në Vetting, ku kjo shumë të jetë përdorur si bazë për krijimin e pasurisë. Ato përveçse janë deklaruar pranë ILDKPKI-së nuk është kryer ndonjë investim, i cili do të kishte si burim financimi këto shuma. Janë përdorur për nevoja personale të jetesës së përditshme dhe për udhëtimet e saj në Greqi për të vizituar prindërit në Selanik. Në lidhje me tatimin mbi të ardhurat për këto shuma të përfituara nga të ardhurat e qirasë sezonale përkatëse gjatë viteve 2010 – 2013 sqaroj se përfituesi i drejtpërdrejtë i këtyre të ardhurave nga prona e tij ka qenë babai i bashkëshortes dhe jo bashkëshortja ime. Ky i fundit ia ka dhënë këto shuma vajzës së tij, siç edhe janë deklaruar në deklaratat periodike. Në lidhje me tatimin e paguar për këto shuma, sqaroj se ka qenë një marrëdhënie transaksioni midis qiramarrësve dhe babait të bashkëshortes, për të cilat ai nuk ka pasur informacion, pasi ka qenë qytetar jo rezident në Republikën e Shqipërisë në këto periudha. Detyrimi për të paguar tatimin mbi të ardhurat për këto shuma ka qenë i babait të bashkëshortes. Unë nuk jam në dijeni në lidhje me pagesën ose jo të tatimit mbi të ardhurat. Për më tepër nuk kam pasur të drejtë ligjore ashtu edhe morale për të ndërhyrë në këtë lloj marrëdhëniesh”.*

4.9 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se këto të ardhura nuk plotësojnë kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, për pasojë, nuk janë llogaritur në analizën financiare të Komisionit dhe as si burim për shpenzimet.

5 Nga verifikimi i sistemit TIMS rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka lëvizur shpesh nga territori i Republikës së Shqipërisë për në Greqi dhe anasjelltas, me automjete të shtetasve të ndryshëm: A. N. M.; E. A. A.; A. A. V.; D. S. S.; V. J. T.; M. B. T.; B. B. K. (përdorues Aurel G. M.); S. B. B. (shoqëria “***”); S. K. Dh.; J. K. Dh.; K. N. L.; G. Q. D.; R. H. D. (shoqëria “***”); E. Ll. Q.; dhe V. S. M..

5.1 Lidhur me këta persona, Komisioni kërkoi informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për çdo procedim penal apo kallëzim ndaj tyre. Informacioni i ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është trajtuar në kuadër të rivlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

18. Analiza financiare për periudhën 10.12.2009 – 2016

18.1 Metodologjia e ndjekur nga Komisioni në analizën financiare është bazuar në dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, në deklaratën Vetting, pyetësorët dhe përgjigjet e pyetësorëve, në informacionin shkresor të ardhura nga bankat, institucionet publike dhe jopublike.

18.2 Në përfundim, rezultati i analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, për periudhën prej fillimit të detyrës 10.12.2009 – 2016, është me vlerë negative të akumuluar në -1,639,624 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) lekë. Në këtë situatë negative financiare nuk është pasqyruar efekti financiar lidhur me shumat e deklaruar të dhuruara para fillimit të detyrës nga të afërmit e bashkëshortes së subjektit dhe mundësia e tij financiare për të krijuar shumën e kursimeve *cash* prej 15,000 (pesëdhjetë mijë) euro.

18.3 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe mundësitë e tij financiare për të përballuar shpenzimet e kryera, të rezultuara gjatë hetimit.

Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i ka kërkuar Komisionit të rishikojë të ardhurat e subjektit për periudhën para fillimit të detyrës lidhur me mundësitë e tij për krijimin e gjendjes *cash*. Po ashtu, subjekti ka kërkuar rilogaritjen e të ardhurave nga paga duke pretenduar se të ardhurat janë në një vlerë më të lartë se ato të llogaritura nga Komisioni në analizë gjatë ushtrimit të detyrës (periudhës së rivlerësimit). Subjekti ka kërkuar llogaritjen në analizë financiare të të ardhurave të përfituara nga dietat dhe urdhërshërbimet.

18.4 Lidhur me shpenzimet e udhëtimit, subjekti ka kërkuar rishikimin e tyre dhe rilogaritjen në bazë të shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej tij. Ka kërkuar të hiqen disa shpenzime si ato për qira për një periudhë kohe, ato për rivlerësimin e pasurisë apartament në Durrës, si dhe të pasurisë apartament në Korçë që rezultojnë të kryera nga llogaria e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, subjekti ka kërkuar që të zbriten nga shpenzimet e jetesës ditët e qëndrimit jashtë vendit, pasi ka të bëjë me dublikim të shpenzimeve të zërit “kosto jetese”, si rrjedhojë e kësaj shpenzimet e jetesës duhet të jenë më të vogla se ato të pasqyruara nga Komisioni. Subjekti kërkon rishikimin e këtyre shpenzimeve në vlerën 2,828,808 (dy milionë e tetëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e tetë) lekë nga vlera 3,645,908 (tre milionë e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e tetë) lekë, llogaritur nga Komisioni.

18.5 Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe llogaritjet edhe një herë shumën e të ardhurave nga paga, ndër vite 2010, 2011, 2014 - 2016, e cila rezultoi në vlerën 6,900,828 (gjashtë milionë e nëntëqind mijë e tetëqind e njëzet e tetë) lekë.

18.6 Komisioni llogariti vlerën e dietave/shërbimeve sipas lëvizjeve të llogarisë, ku rezultojnë vlera e përfitur nga dietat/shërbimet është në shumën 343,873 (treqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, duke reflektuar këtë ndryshim në analizën financiare në vitin 2015. Të ardhurat nga dietat dhe udhëtimet janë përfshirë te shpenzimet e jetesës. Lidhur me kërkesën e subjektit për të zbritur nga shpenzimet e jetesës ditët e qëndrimit jashtë vendit nuk është pranuar, pasi shpenzimet e jetesës të llogaritura nga Komisioni janë shpenzime të minimumit jetik, ndërkohë që shpenzimet e kryera për udhëtime jashtë Shqipërisë janë shpenzime për turizëm, të deklaruara nga subjekti dhe ato të llogaritura në mënyrë hipotetike, mbështetur në referenca dhe kosto minimale.

18.7 Lidhur me shpenzimet e udhëtimeve sipas të dhënave nga sistemi *TIMS*, Komisioni ka marrë në konsideratë në analizën financiare vlerën 1,100 (një mijë e njëqind) euro, kërkuar nga subjekti për rimbursimin e shpenzimeve të udhëtimit/akomodimit të deklaruar si udhëtime për qëllime pune, pasi paraqiti dokumentacionin përkatës se shpenzimet për këto trajnime në vitin 2011 ishin paguar në vijim të marrëdhënies së punës dhe jo nga subjekti i rivlerësimit.

18.8 Subjekti ka kërkuar rishikimin e çmimit të biletës së autobusit për linjën Korçë-Selanik-Korçë, duke depozituar dokumentacion provues lidhur me të. Komisioni ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit duke bërë ndryshimet në vitet përkatëse kur ai/familja e tij ka udhëtuar me autobus.

18.9 Janë marrë në konsideratë kërkesat e subjektit për mosllogaritjen e shpenzimeve të rivlerësimit të pasurive, përkatësisht për vjehrrin e tij dhe babain, duke vlerësuar se janë detyrime të zotëruesve të pasurive përkatëse dhe se shpjegimet e subjektit gjenden të drejta.

18.10 Lidhur me shpenzimet e qirasë për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë dokumentacion provues se ka jetuar në apartamentin me qira deri në dhjetor të vitit 2010, pavarësisht se ka deklaruar si adresë banimi në DPV-në e vitit 2011 adresën e apartamentit të marrë me qira. Komisioni pranoi shpjegimet e subjektit duke mos përfshirë në analizë shpenzime qiraje për vitin 2011, në vlerën 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

18.11 Lidhur me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për gjendjen *cash* në analizën financiare është pasqyruar gjendja e deklaruar në deklaratimet periodike vjetore, e cila megjithëse nuk përputhet me gjendjen e deklaruar në deklaratën *Vetting*, Komisioni vlerësoi të mos pranojë shpjegimet e subjektit, të cilat nuk gjejnë pasqyrim në asnjë DPV dhe për të cilat krijohet bindja se janë bërë për të justifikuar shpenzime të pambuluara financiarisht për efekt të procesit të rivlerësimit.

18.12 Në vijim, Komisioni ka pasqyruar ndryshimet në analizën financiare për periudhën 10.12. 2009 – 2016, nga ku subjekti rezulton në vlerën negative prej -512.285 (peseqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekësh.

19. Truall me sip. 150 m², pronarë të kësaj pasurie janë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, ku nga kjo sipërfaqe janë 71 m² ndërtesë, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Korçë, blerë me Kontratën e Shitjes me Kusht Kreditimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.6.2019, në vlerën 4,000,000 (katër milionë) lekë, nga bashkëpronarët A. H. etj. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me bashkëshorten nga 50 %. Burimi i financimit sipas Kontratës së Kredisë me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 2.7.2019, lidhur me “Fi BANK”.

19.1 Kjo pasuri është deklaruar në DIPV-në e vitit 2019, si: “*Shtim i pasurisë së paluajtshme, me sip. trualli 150m², nga kjo ndërtesë 71 m², në shumën 4,000,000 lekë*”. Në DIPV-në e vitit 2019, nga subjekti i rivlerësimit është deklaruar edhe kredia e akorduar nga “Fi BANK” në emër të tij dhe të bashkëshortes në shumën 8,000,000 (tetë milionë) lekë me këst mujor mesatar 104,487,92 (njëqind e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë e nëntëdhjetë e dy qindarka) lekë për vitin 2019. Nga kredia e akorduar, shuma prej 4,000,000 (katër milionë) lekësh është përdorur për blerjen e pasurisë truall me sip. 150 m² nga kjo ndërtesë 71 m² dhe shuma prej 4,000,000 (katër milionë) lekësh i ka kaluar subjektit ndërtues “****” për rikonstruksion dhe shtesë objekti sipas lejes së ndërtimit.

19.2 Drejtoria Vendore Korçë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka konfirmuar për Komisionin këtë pasuri me shkresat nr. *** prot., datë 20.2.2020 dhe nr. *** prot., datë 8.2.2021, ku ka dërguar praktikën e plotë të kalimit të pasurisë të subjekti i rivlerësimit, dokumentacionin e plotë të origjinës së pasurisë, si dhe vlerën e shitjes së pasurive të paluajtshme të ngjashme në këtë zonë.

19.3 Nga dokumentacioni i përcjellë rezulton se për ndërtimin e këtij objekti janë marrë dy leje ndërtimi në Bashkinë Korçë: (a) leje me nr. ***, datë 17.9.2019, me objekt rikonstruksion dhe shtesë banese 2-katëshe, me përshkrimin 2 kate ndërtimi (sip. 194 m² në total ndërtim) në gjurmë ndërtimi me sip. 97 m², shtesë gjurme me sip. 26 m² nga gjurma ekzistuese me sip. 71 m²; dhe (b) leje ndërtimi për shtesë me nr. ***, datë 3.3.2020, me përshkrimin “2 kate ndërtim me sip. 194 m² + 1 kat bodrum me sip. 97 m²”, pra në total 291 m² ndërtim.

19.4 Nga hetimi për këtë pasuri ka rezultuar se vlerat e preventivëve për koston e ndërtimit të paraqitur në Bashki dhe të faturuar nga shoqëria e ndërtimit janë më të ulëta se kostoja e përlllogaritur duke iu referuar kostove të EKB-së, por subjekti i rivlerësimit ka paraqitur fatura dhe preventivë, të cilët kanë vlerën e provës.

19.5 Në kuptim të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Komisionit vlerësoi se rivlerësimi i pasurisë për subjektet e rivlerësimit sipas ligjit, duhet të jetë vetëm për çështje që kanë ndodhur brenda periudhës së rivlerësimit. Verifikimi i pasurive të subjektit për periudhën 2017-2018-2019-2020 e në vijim është një proces që duhet të kryhet nga ILDKPKI-ja. Ky arsyetim vjen edhe në bazë të paragrafit 59, të vendimit nr. 25/2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, e të tjerë vijues të këtij Kolegji. Kjo pasuri nuk lidhet me ndonjë pasuri apo vlerë monetare të krijuar gjatë periudhës së rivlerësimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

20. Komisioni vlerëson se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* janë të paplota dhe të pamjaftueshme, pasi aty nuk gjejnë pasqyrim të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite, burimi i krijimit të tyre apo të drejtat reale mbi to. Subjekti ka fshehur në deklaratën *Vetting* të ardhura të deklaruara prej tij dhe personit të lidhur në DPV-në e vitit 2009 (deklarimi para fillimit të detyrës) nga dhurimi, si dhe të drejta reale mbi të ardhurat nga qiraja, e se ato nuk janë në koherencë me deklaratimet periodike vjetore. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, lidhur me gjendjen *cash*, nuk përputhen e nuk vijnë në harmoni me deklaratimet periodike vjetore të kryera prej tij.

21. Trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë duke paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij dhe se nuk arriti të bindë trupin gjykues për të kundërtën duke u ndodhur në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të

Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit”.

22. Në vlerësim të rrethanave të sipërcituara në vendim, Komisioni çmon se sjelljet dhe veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasuritë: (a) dhuratë në shumën 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro; dhe (b) shuma 4,440,000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë me të ardhura nga qiratë, janë të pabesueshme dhe se për to nuk u provua burimi i krijimit sipas kërkesave të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe as kthimi i tyre. Deklarimet e subjektit nuk gjenin mbështetje në ndonjë deklaram periodik vjetor dhe se mbetën në kontekstin deklarativ edhe gjatë procesit të rivlerësimit. Këto sjellje të subjektit të rivlerësimit, në vlerësim të trupit gjykues të Komisionit krijuan bindjen se ndodhet para një deklarimi të rremë në vitin 2009, ose para fshehjes së kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* dhe, për rrjedhojë, këto sjellje u konsideruan të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti ka vepruar në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

23. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. DSIK-ja ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit datë 2.11.2017, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

24. Komisioni i ka kërkuar informacion institucioneve ligjzbatuese dhe DSIK-së nëse disponojnë informacion të rifreskuar/përditësuar për subjektin e rivlerësimit.

25. Në vijim, DSIK-ja ka dërguar në datën 16.3.2021 raportin e rishikuar mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Gentian Stoja, në përfundim të të cilit autoritetet verifikuese deklarojnë se ndryshojnë konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës. DSIK-ja, në raportin e rishikuar, ka konstatuar se: “Në kohështrirjen gjatë periudhës së rivlerësimit të tij ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive; ushtrim të ndikimit të paligjshëm në disa procese penale, ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”.

26. Komisioni hetoi lidhur me të dhënat dhe *indiciet* e grumbulluara nga denoncime, si dhe informacione të klasifikuara dhe kërkoi informacionet si vijojnë:

- a) me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2021, ka kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me kallëzimet/procedimet penale për vitet 2018 – 2020, ndaj shtetasve M. B., H. C., K. H., K. P., R. Sh. dhe G. X., me detyrë doganierë;
- b) me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2021, kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me procedimin penal nr. ***, të vitit 2020 ndaj operatorit ekonomik “****” sh.p.k., për veprën penale “përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”;
- c) me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2021, kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lidhur me kallëzimet/procedimet penale ndaj shtetasve A. K., M. D., B. M. dhe B. M., me detyrë doganierë;
- ç) me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2021, kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me procedimin penal të vitit 2016 ndaj shtetasit L. K., për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “kontrabandë”;
- d) me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2021, kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me procedimin penal të vitit 2012 ndaj shtetasit A. V. S., për veprën penale “armëmbajtje pa leje”;
- dh) me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2021, kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me procedimet penale apo kallëzimet ndaj pjesëtarëve të bandës së njohur në Korçë me emrin “****”;

- e) me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021, kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me procedimet penale apo kallëzimet ndaj shtetasit K. M.;
- ë) me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021, kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me procedimet penale apo kallëzimet ndaj shtetasit M. K.;
- f) me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021, kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me procedimet penale apo kallëzimet ndaj shtetasit X. M..

27. Nga informacioni i dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nuk rezultoi që prokurori Gentian Stoja të ketë qenë në shumicën e çështjeve të cituara më lart, por rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka nën hetim: (a) procedimin penal ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., për veprën penale “përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”; (b) procedimi penal nr. **, ku të kallëzuar janë shtetasit B. M., H. C., K. M., M. K., Xh. M. për veprën penale “tregtim dhe transportim i mallrave që janë kontrabandë”.

28. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegojë lidhur me veprimet e kryera dhe afatin për përfundimin e hetimeve lidhur me procedimin penal ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., për të cilat nuk janë kryer veprimet e duhura procedurale dhe se subjekti duket se ndodhet në shkelje të hapur me ligjin procedural penal. Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë nëse ka njohje miqësore apo lidhje të tjera me shtetasit B. M. dhe H. C. dhe a ka gjykuar këtë çështje në kushtet e konfliktit të interesit.

29. Në Komision është depozituar denoncimi i shtetasës M. P.¹⁷ dhe një denoncim anonim¹⁸ që, ndër të tjera, akuzojnë subjektin e rivlerësimit për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar në qytetin e Korçës. Sipas denoncuesve, subjekti i rivlerësimit ka përdorur shtetasin M. A. (i arrestuar aktualisht për armëmbajtje pa leje) për të dhunuar shtetasin K. Q., i cili pas dëmtimeve dhe në gjendje të rënduar psikologjike ka vrarë veten, gjë e cila provohet nga dosja në Prokurorinë e Pogradecit.

30. Lidhur me këtë denoncim, Komisioni, kërkoi informacion si vijon:

- a) me shkresën nr. *** prot., datë 17.12.2020, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec kërkoi dosjen penale lidhur me kanosjen ndaj shtetasit K. Q.;
- b) me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë kërkoi fashikullin hetimor mbi kallëzimin nr. **, të vitit 2020, të shtetasit K. Q., në cilësinë e viktimës së goditur me sende të forta;
- c) me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2021, kërkoi informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në procedimin për veprën penale “shkaktim i vetëvrasjes”, si dhe mbi gjendjen mendore të shtetasit K. Q..

31. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka paraqitur fashikullin¹⁹ që i përket procedimit penal nr. **, viti 2020, për të cilin është vendosur mosfillimi, ku shtetasi K. Q. ka pasur cilësinë e viktimës pasi është goditur me sende të forta nga persona të pidentifikuar.

32. Nga administrimi i fashikullit të procedimit penal nr. **, viti 2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezultoi se në datën 29.4.2020, shtetasi K. Q. është dhunuar nga 3 persona, por nuk është paraqitur te mjeku ligjor për t’u ekzaminuar, si dhe në kallëzimin e datës 29.4.2020, përpara oficerit të policisë gjyqësore shprehet se nuk kërkoi të bëjë ankim për personat që e kanë dëmtuar, duke nënshkruar edhe procesverbalin e datës 12.5.2020 për heqjen dorë nga e drejta e ankimit. Në përfundim, me vendimin e datës 12.5.2020, prokurori pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur: “Mosfillimin e kallëzimit penal nr. **, të vitit 2020, regjistruar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal”.

¹⁷Denoncim nr. *** prot., datë 3.12.2020, nga znj. M. P..

¹⁸Denoncim anonim nr. *** prot., datë 17.12.2020.

¹⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

33. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec informon se kishte regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 13.7.2020, për veprën penale “shkaktim i vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, me viktimë shtetasin e ndjerë K. Q., i cili ishte dërguar për kompetencë lëndore nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Prokuroria ka informuar Komisionin se kjo çështje është nën hetim.

34. Komisioni kërkoi në vijim informacion lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe rolin e tij në këtë çështje penale, gjendjen mendore të shtetasit K. Q., si dhe mbi përfshirjen në këtë procedim të shtetasve M. A., E. F. dhe K. M. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec ka informuar²⁰ si vijon:

- a) Subjekti i rivlerësimit përmendet në deklaratimet e familjarëve (motrës dhe prindërve) të viktimës K. Q., si personi që hamendësojnë se ka shtyrë persona të paidentifikuar për të goditur viktimën. Emri i shtetasit Gentian Stoja nuk është regjistruar në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.
- b) Mbi gjendjen mendore të viktimës, sipas informacionit të Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor Korçë dhe deklaratimeve të familjarëve dhe rrethit shoqëror të viktimës, evidentohen të dhëna për anamnezë psikiatrike dhe tentativa të mëparshme vetëvrasjeje.
- c) Shtetasit M. A., E. F. dhe K. M. nuk përmenden në deklaratimet e familjarëve të viktimës dhe në asnjë prej akteve të procedimit penal.

35. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur²¹ nga Komisioni lidhur me njohjen me shtetasin K. Q., shprehet se: *“Shtetasin K. Q. e kam njohur për arsye se ka qenë koleq pune me bashkëshorten time në Bashkinë Maliq”.*

36. Me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2021, Komisioni kërkoi informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lidhur me kallëzimet/procedimet penale ndaj shtetasve M. A. dhe K. M..

37. Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është dërguar informacion²² lidhur me kallëzimet/procedimet penale ndaj shtetasve M. A. dhe K. M., ku rezulton se:

- a) Ndaj shtetasit M. A. janë regjistruar 6 procedime penale, për veprat si vijojnë: (1) procedimi nr. *** për veprën penale “vjedhje me armë” (dënuar me 14 vjet burgim); (2) procedimi nr. *** për veprën penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt” (dënuar me gjobë); (3) kallëzimi nr. *** për veprën penale “mosbindje të urdhrimit të punonjësit të policisë” (mosfillim); (4) procedimi nr. *** për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të policisë” (dënuar me 2 muaj burgim); (5) procedimi nr. *** për veprën penale “armëmbajtje pa leje” (në hetim); (6) procedimi nr. *** për veprën penale “largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit” (në hetim).
- b) Ndaj shtetasit K. M. janë regjistruar 4 procedime penale për veprat si vijojnë: (1) procedimi nr. *** për veprën penale “vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” (dënuar 8 muaj me kusht); (2) procedimi nr. *** për veprat penale “vjedhje me armë”, “mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe “kanosje” (dënuar me 2 vjet burgim); (3) kallëzimi nr. *** për veprën penale “kanosje” (mosfillim i procedimit); (4) procedimi nr. *** për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” (në proces).
- c) Asnjëri prej kallëzimeve/procedimeve penale ndaj shtetasve M. A. dhe K. M. nuk është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit.

38. Në vijim, Komisioni ka pyetur²³ edhe subjektin e rivlerësimit mbi njohjen e tij me shtetasin M. A. dhe nëse kishte pasur çështje penale në ngarkim të këtij shtetasi gjatë ushtrimit të detyrës. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk ka njohje dhe nuk ka pasur asnjë çështje penale me këtë shtetas gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror dhe oficer i policisë gjyqësore.

²⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

²¹Shihni përgjigjen nr. 3 të pyetësorit datë 17.12.2020.

²²Shihni shkresat nr. *** prot., datë 11.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 12.2.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

²³Shihni përgjigjen e pyetësorit datë 3.12.2020 dhe përgjigjen nr. 3 të pyetësorit të datës 2.2.2021.

39. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur²⁴ nga Komisioni lidhur me njohjen e tij me shtetasin K. M., deklaroi se nuk ka njohje me këtë shtetas.
40. Lidhur me këtë denoncim si dhe me indicie të tjera të mbledhura sipas parashikimeve të neneve 34-39, 53, e vijues të ligjit nr. 84/2016, pas verifikimeve nuk rezultuan të dhëna për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të lidhur me krimin e organizuar sipas parashikimeve të pikës 15 të nenit 3 të ligjit, megjithëse rezultoi se subjekti i rivlerësimit njihej me shtetasin K. Q. dhe se ai ishte dhunuar në datën 29.4.2020, nga 3 persona, për të cilën kishte iniciuar edhe procedimin penal nr. ***, viti 2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe që kishte përfunduar me mosfillim.
41. Sipas disa të dhënave nga një denoncimi anonim, kishte *indicie* se subjekti i rivlerësimit qarkullon me automjete me targa të falsifikuara dhe në bashkëpunim me shoferin e prokurorisë, shtetasin K. L., merr targat e automjetit të prokurorisë për të qarkulluar kur në automjet ka pije të futura kontrabandë, me qëllim shmangien e kontrollit policor gjatë udhëtimeve Kapshticë - Korçë, Qafë Thanë - Korçë dhe Tushemisht - Korçë, të cilat i tregton më pas në lokalim “***” në Korçë.
42. Lidhur me këtë denoncim, Komisioni²⁵ kreu disa verifikime dhe hetime nga ku nuk rezultuan të dhëna vijuese mbi ndonjë veprimtari të kundërligjshme.
43. Subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni²⁶ lidhur me përdorimin e automjetit tip “SAAB” ngjyrë gri të errët, i cili nuk rezultoi në pronësi të tij, por shpjegoi se ky automjet ndodhet në garazhin e Prokurorisë Korçë në cilësinë e provës materiale dhe është përdorur nga prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore pranë SHÇBA-së Korçë, vetëm për nevoja të ngutshme pune, duke kryer me këtë automjet veprime procedurale me metoda speciale hetimi.
44. Në vijim, Komisioni e ka pyetur²⁷ subjektin e rivlerësimit nëse ka pasur ndonjë akt përdorimi dhe autorizim për përdorimin e këtij automjeti dhe targat me të cilat ka lëvizur, i cili sqaroi se ky automjet është sekuestruar në cilësinë e provës materiale në lidhje me procedimin penal nr. ***, që është ende nën hetim prej tij dhe ky automjet është përdorur në disa raste të veçanta për veprime operationale për llogari të procedimit penal nr. ***, ende nën hetim prej tij.
45. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përdorur automjetin tip “SAAB”, të sekuestruar në cilësinë e provës materiale në një procedim penal ende nën hetim dhe për përdorimin e tij duket se nuk ka pasur akt përdorimi apo autorizim të përdorimit, në përputhje me rregullat dhe procedurat e institucionit.
46. Komisioni i kërkoi informacion Prokurorisë së Përgjithshme²⁸ lidhur me kontrollet e ushtruara të përgjithshme, tematike apo në bazë ankese për subjektin e rivlerësimit, e cila (sektori i protokollit dhe arkivit) me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2020, sqaroi se nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Kallëzimeve dhe Procedimeve Penale të Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezultoi të ketë çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit.
47. Komisioni kërkoi informacion në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për subjektin e rivlerësimit, e cila informon²⁹ se në regjistrin e njoftimit të veprave penale pranë kësaj prokurorie dhe pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk rezultoi që në emër të shtetasit Gentian Stoja të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Ndërkohë, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar informon se ndaj shtetasit Gentian Stoja janë regjistruar kallëzimet penale nr. ***, vitit 2020 dhe nr. ***, viti 2020, për të cilët pas verifikimit është vendosur mosfillimi i tyre, si dhe janë dërguar kopje të njësuar me origjinalin të vendimeve të mosfillimit.
48. Referuar vendimeve ka rezultuar se për kallëzimet penale të depozituara pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për subjektin e rivlerësimit, pas

²⁴Shihni përgjigjen nr. 4 të pyetësorit datë 17.12.2020.

²⁵Shihni përgjigjen nr. 5 të pyetësorit datë 17.12.2020.

²⁶Shihni përgjigjen nr. 2, të pyetësorit datë 2.2.2021.

²⁷Shihni përgjigjen nr. 1, të pyetësorit datë 12.2.2021.

²⁸Shkresa nr. *** prot., datë 23.1.2020.

²⁹Shkresa nr. *** prot., datë 18.3.2021.

kryerjes së veprimeve hetimore nuk janë evidentuar *indicie*, fakt apo provë mbi ekzistencën e veprës penale.

49. Në vijim të rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqiste qëndrimin e tij lidhur me gjetjet e Komisionit dhe rezultatet e hetimit.

50. Subjekti ka shprehur qëndrimin e tij lidhur me raportin e DSIK-së se gjetjet e përditësuara nuk janë të vërteta dhe se nuk kanë asnjë provë apo informacion të vërtetë. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime edhe lidhur me veprime e mosveprime hetimore të kryera prej tij për procedimin penal ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe njohje miqësore apo lidhje të tjera me shtetasit B. M. dhe H. C. (persona nën procedim penal prej tij)³⁰.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

51. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësimit të deklaratës së figurës. Nga rrethanat e konstatuara nga Grupi i Punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, nuk rezultojnë se ai ka bërë deklaram të pamjaftueshëm sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

52. Për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e pikave 2 apo 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, por se konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen nga Komisioni, në vlerësimin në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit Gentian Stoja, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

53. Ky raport profesional është përgatitur bazuar në raportin e sjellë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimet e paraqitura pranë Komisionit si dhe Gjetjet e evidentuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

54. Nga raporti i sjellë në Komision nga KLP-ja kanë rezultuar problematika në dosjen nr. 3, konkretisht:

54.1 Dosja 3 – procedimi penal nr. ***, datë regjistrimi 26.10.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Objekti i shortit: dokumenti ligjor - vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë 26.1.2016, për procedimin penal nr. ***.

i. Në datën 26.1.2016, subjekti i rivlerësimit Gentian Stoja ka përpiluar “Vendimin për pushimin e çështjes”, në mbështetje të germës “f”, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale ku ka vendosur:

a) Të pushojë procedimin penal nr. ***, të vitit 2015.

b) Vendimi t’u njoftohet të interesuarve.

c) Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë.

ii. Nga vëzhgimi që i bëhet fashikullit të procedimit penal konstatohet se vendimi i pushimit objekt, bazuar në pikën 5, të nenit 24, të Kodit të Procedurës Penale, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën 16.2.2016. Në vendimin e shfuqizimit janë evidentuar shkaqet se përse ky procedim nuk duhej të pushohej e konkretisht: “ç) Vendimi i pushimit të procedimit penal nr. ***, viti 2015, është marrë në vlerësim të gabuar të provave të administruara dhe pa kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm. Në këtë rast janë renditur disa veprime procedurale që duhet të ishin realizuar, pasi do të përbënin rëndësi për hetimin si pyetja e shtetasit nën hetim për vendndodhjen e tij gjatë periudhës kohore kur pretendohet të jetë kryer ndërtimi paraprak, përcaktimi i pronësisë mbi tokën, si dhe do të ishte administrimi i akteve të marrjes së tokës në pronësi sipas ligjit nr. 7501, etj.”

iii. Pas shfuqizimit të vendimit të pushimit nga ana e prokurorit, subjekti i rivlerësimit Gentian Stoja ka kryer veprime të tjera hetimore. Në përfundim të tyre, në datën 17.5.2016, prokurori

³⁰Për më shumë informacion referojuni dokumentit “shpjegime mbi rezultatet e hetimit”.

ka disponuar sërish me vendim pushimi duke i qëndruar të njëjtit argument si në rastin e vendimit të pushimit datë 26.1.2016.

iv. Pasi është njohur me vendimin sa më lart, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën 20.5.2016 ka shfuqizuar vendimin e pushimit datë 17.5.2016.

v. Në vendimin e shfuqizimit Drejtuesi i Prokurorisë bën një interpretim të ndryshëm sa i përket ligjit nr. ***, “Për planifikimin dhe rregullimin e territorit” dhe VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015. Konkretisht, me parashikimet e VKM-së në nenin 2 jepen përkufizimet se cilat quhen punime e referuar kësaj, punimet që po kryheshin në momentin e konstatimit në pronën e shtetasit E. P. kanë qenë të tilla që kërkonin leje ndërtimore. Ndërtimi që ka qenë duke kryer subjekti i veprës penale, qoftë dhe veshja me gur, që në fakt punimet kanë qenë më të avancuara bëjnë pjesë në ndryshimin e formës, dizajnit etj., dhe si të tilla kërkojnë leje ndërtimi sipas ligjit nr. 107/2014, leje për të cilën shtetasi nuk ka aplikuar.

vi. Në përfundim, Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur: (a) shfuqizimin e vendimit të pushimit datë 17.5.2016; (b) zëvendësimin e prokurorit Gentian Stoja me një prokuror tjetër; (c) zëvendësimin e oficerit të policisë gjyqësore me një tjetër o.p.gj; (ç) urdhërimin për kryerjen e veprimeve hetimore që kanë të bëjnë me njoftimin e akuzës dhe dërgimin e çështjes për gjykim, pasi provat janë të plota; (d) me këtë vendim të njoftojë prokurorin, që ka të drejtën e ankimit te prokurori më i lartë.

vii. Bazuar në vendimin e shfuqizimit, prokurori i ngarkuar me kryerjen e veprimeve procedurale në çmim të të dhënave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”.

viii. Në analizë të fakteve, prokurori ka vlerësuar se të pandehurit E. P. dhe O. P. me veprime aktive, të kundërligjshme kanë konsumuar veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, akuzë të cilën të pandehurit e kanë pranuar.

ix. Në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale është përpiluar edhe kërkesa për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit.

x. Pas shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 4.7.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit E. P. për kryerjen e veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, duke e dënua pas aplikimit të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale me 2 muaj burgim, i cili është pezulluar duke e vënë në kohë prove.

54.2 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqiste qëndrimin e tij lidhur me konstatimet e bëra në raportin e vlerësimit.

54.3 Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se: “... duke lexuar me vëmendje provat e kërkuara nga prokuroria në kërkesën për gjykim, por edhe në konkluzionet përfundimtare të prokurorit konstatohet lehtësisht se prokurori i seancës i ka kërkuar gjykatës, përveç të tjerave marrjen si provë vetëm të aktekspertimit teknik të caktuar me vendimin e datës 2.11.2015, por nuk ka kërkuar marrjen si provë të aktekspertimit të datës 7.5.2016, çka ka çuar në konkluzion të gabuar gjykatën duke e dënua shtetasin E. P.”.

55. Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se ndaj prokurorit Gentian Stoja nuk ka masë disiplinore. Nga verifikimi i të dhënave nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para, si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezultoi se për subjektin nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.

56. Nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën 2006 – 2020, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit Gentian Stoja është regjistruar një ankesë si vijon:

56.1 Praktika nr. ***, viti 2019, regjistruar pas ankesës së shtetasit P. D., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, ndaj prokurorit Gentian Stoja. Shtetasi P. D. ka paraqitur ankesë pasi pretendon se prokurori Gentian Stoja në mënyrë

arbitrare ka vendosur mosfillimin si procedim penal ndaj një kallëzimi të bërë nga ankuesi. Ankesa në fjalë, pasi është marrë në shqyrtim nga Drejtoria Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 24.4.2019, i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ky rast është trajtuar më poshtë në këtë vendim të denoncimi nr. ***.

57. Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Gentian Stoja, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë, duke përjashtuar rastin e vendimit të pushimit për procedimin penal nr. ***, viti 2015, i cili i është shfuqizuar e më tej autori është deklaruar fajtor nga gjykata. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Gentian Stoja për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale në cilësinë e prokurorit është vlerësuar “shumë mirë”, ndërsa në vitin 2012 është vlerësuar “mirë”.

58. Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga prokurori dhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit Gentian Stoja shfaq aftësi në arsyetim ligjor dhe tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme. Në aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

VLERËSIMI I DENONCIMEVE

59. Në Komision janë paraqitur 8 denoncime për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Denoncimet, për të cilat janë konstatuar *indicie* janë kryer hetime të plota duke kërkuar dosjet gjyqësore, si dhe shpjegime të detajuara prej subjektit³¹.

1. **Denoncim anonim**³², sipas të cilit hidhen dyshime për paaftësinë në detyrë dhe për të provuar këtë mjafton të merren dosjet e shfuqizuara të viteve 2015 dhe 2016, ku provohen shkeljet lidhur me pushimin e procedimeve penale, të cilat pasi janë prishur dhe dërguar në gjykatë, autorët janë dënuar mbi 5 vjet burgim.

1.1 Lidhur me këtë denoncim, Komisioni³³ kërkoi informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Nga informacioni i dërguar rezulton se:

1.1.1 Subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2015 – 2017, ka përfunduar 556 çështje penale, nga të cilat 116 janë dërguar për gjykim, për 188 çështje është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për 136 çështje është vendosur pezullimi i procedimit penal, për 102 çështje është vendosur pushimi i procedimit penal, 8 çështje janë transferuar dhe 6 janë urdhra penalë.

1.1.2 Për periudhën 2015 – 2016, subjektit të rivlerësimit i janë shfuqizuar 13 vendime nga Drejtuesi i Prokurorisë, nga të cilat 8 vendime pushimi të procedimit penal, 4 vendime mosfillimi të procedimit penal dhe 1 vendim për dërgim për gjykim të procedimit penal.

1.2 Nga vlerësimi i vendimeve të shfuqizuara të subjektit të rivlerësimit vihet re se:

- a) Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, si i marrë në vlerësim të gabuar të provave të mbledhura gjatë procedimit dhe pa kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.
- b) Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “kundërshtim të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi është marrë në vlerësim të gabuar të provave të mbledhura dhe pa kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.
- c) Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “falsifikim i vulave, stampave apo formularëve”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi është marrë

³¹Për më shumë referojuni dokumentit të rezultateve të hetimit dhe shpjegimeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit.

³²Denoncim anonim nr. *** prot., datë 17.12.2020.

³³Shkresa nr. *** prot., datë 17.12.2020.

në mungesë të provave dhe me paraqitjen e provave është i domosdoshëm vazhdimi i hetimeve.

- c) Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “falsifikim i vulave, stampave apo formularëve”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi është marrë në mungesë të provave dhe me paraqitjen e provave është i domosdoshëm vazhdimi i hetimeve.
- d) Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi është marrë pa kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe duke konsideruar prova që vijnë ndesh me njëra-tjetrën.
- dh) Vendimi për pushimin e çështjes penale nr. ***, për veprën penale “mashttrim në sigurime”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi është marrë në vlerësim të gabuar të provave të mbledhura dhe në interpretim të gabuar të dispozitave të ligjit material penal.
- e) Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “mashttrim në sigurime”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi është marrë në vlerësim të gabuar të provave të mbledhura dhe në interpretim të gabuar të dispozitave të ligjit material.
- ë) Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “mashttrim në sigurime”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi është marrë në vlerësim të gabuar të provave të mbledhura dhe në interpretim të gabuar të dispozitave të ligjit material. Për ushtrimin e ndjekjes penale lidhur me këtë procedim është caktuar një prokuror tjetër.
- f) Vendimi për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin kallëzues nr. ***, referuar për veprën penale “vjedhje”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi fakti se midis palëve ekzistonte një marrëdhënie kontraktore nuk do të thotë automatikisht se nuk ka elemente të veprave penale.
- g) Vendimi për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin kallëzues nr. ***, referuar për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi veprimet verifikuese nuk janë të plota dhe është e nevojshme kryerja e një sërë veprimesh hetimore.
- gj) Vendimi për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin kallëzues nr. ***, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi në rastin konkret ka të bëjë me elementët e veprës penale “vjedhje” dhe në lidhje me faktet objekt kallëzimi është e nevojshme kryerja e një sërë veprimesh hetimore.
- h) Vendimi për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin kallëzues nr. ***, referuar për veprën penale “pushtimi i tokës”, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi veprimet verifikuese nuk janë të plota dhe ka nevojë për veprime hetimore.
- i) Vendimi për njoftimin e akuzës ndaj shtetasit T. K., për veprën penale “dhunim të banesës” dhe dërgimin e çështjes për gjykim për procedimin penal nr. ***, është shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi akuza është komunikuar pa e specifikuar paragrafin e nenit dhe vendimmarrja është marrë në vlerësim të gabuar të provave të grumbulluara, pa kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe duke ushtruar në mënyrë të gabuar ndjekjen penale.

1.3 Në përfundim, nga analiza e vendimeve të shfuqizuara, rezulton se:

- a) Vendimet e pushimit të procedimeve penale duket se janë marrë në mungesë të provave apo në vlerësim të gabuar të provave të mbledhura dhe pa kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.
- b) Vendimet e mosfillimit të procedimeve penale janë marrë pa kryer në mënyrë të plotë veprimet verifikuese dhe ka qenë e nevojshme kryerja e një sërë veprimesh të tjera hetimore.
- c) Vendimi për njoftimin e akuzës është marrë pa e specifikuar paragrafin e nenit dhe dërgimi i çështjes për gjykim është marrë në vlerësim të gabuar të provave të grumbulluara, pa kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe duke ushtruar në mënyrë të gabuar ndjekjen penale.

1.4 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime dhe informacion lidhur me vendimmarrjen përfundimtare të prokurorisë dhe gjykatës për secilin nga rastet.

1.5 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar për secilin rast shkaqet e vendimmarrjes nga ana e tij dhe ka dhënë shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit³⁴.

2. **Denoncimi i shtetasit Th. Gj.**³⁵. Objekti i denoncimit: denoncon për shkelje të etikës profesionale dhe vendim të padrejtë për pushimin e procedimit penal prokurorin Gentian Stoja dhe gjyqtaren F. D.. Denoncuesi pretendon se procedimi penal është pushuar pa hetuar Agjencinë e Trajtimit të Pronave, megjithëse nga ana e tij është vënë në dispozicion gjithë dokumentacioni, si dhe një dokument i falsifikuar.

2.1 Lidhur me këtë denoncim nuk janë konstatuar të dhëna që mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin profesional për subjektin e rivlerësimit.

3. **Denoncimi nga shtetasi H. K.**³⁶. Objekti i denoncimit: denoncon për vendim të padrejtë për pezullimin e hetimeve. Denoncuesi, në datën 23.5.2018, ka bërë kallëzim penal për shpërdorim detyre bazuar në nenin 248 të Kodit Penal, ndaj ish-kryetarit të Komunës ***, T. D., ish-shefes së financës A. M. për lidhjen e një kontrate fiktive në datën 8.1.2007, e cila është rilidhur nga kryetari i komunës A. B. për periudhën 2011 - 2021.

a) Sipas denoncuesit, nga subjekti i rivlerësimit në datën 31.10.2018 janë pezulluar hetimet, me gjithë provat e sakta të depozituara prej tij. Në denoncim nuk referohen fakte ose rrethana që lidhen me pretendimet e mësipërme dhe nuk shoqërohen me prova që kanë lidhje me denoncimin.

b) Lidhur me këtë denoncim, Komisioni kërkoi³⁷ informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2021, dërgoi fotokopje të fashikullit të kallëzimit penal nr. ***, me kallëzues shtetasin H. K..

c) Referuar fashikullit të kallëzimit penal rezulton se denoncuesi, më 9.5.2018, ka depozituar kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë ndaj ish-Komunës *** me përfaqësues T. D., i cili ka bërë një kontratë qiraje me subjektin “***” me përfaqësues shtetasin M. M. dhe një shtetas të huaj grek I. T.. Sipas kallëzimit, këta persona në bashkëpunim me ish-shefen e financës shtetasen A. M. dhe pronarët P. D. dhe R. K., kanë dhënë me qira në fshatin *** objektin Qendra Tregtare ***. Sipas kallëzuesit, subjekti “***” në momentin që ka bërë Kontratën e Qirasë datë 8.1.2007 nuk ka qenë i regjistruar, por është regjistruar 10 ditë më vonë në QKR.

ç) Lidhur me këtë kallëzim, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 23.5.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se pretendimet e kallëzuesit janë të karakterit juridiko-civil, marrëdhënie e cila është normuar me kontratën e qirasë, në të cilat është sanksionuar se zgjidhja e mosmarrëveshjeve, në rast se nuk zgjidhet me mirëkuptim nga palët bëhet objekt gjyqësor.

d) Vendimi i mosfillimit i është dërguar denoncuesit me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe mbi këtë vendim nuk rezulton të jetë ushtruar ankim në gjykatë.

dh) Nga shqyrtimi i fashikullit të kallëzimit penal rezulton se vendimi i mosfillimit të procedimit penal datë 23.5.2018 i është njoftuar kallëzuesit me shkresën e datës 31.10.2018, pra me rreth 5 muaj vonesë.

3.1 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me pretendimet e ngritura në denoncim, si dhe arsyet e dërgimit me vonesë të vendimit të mosfillimit të procedimit penal.

3.2 Në shpjegimet e tij, subjekti ka informuar Komisionin se pas regjistrimit të procedimit penal nr. ***, viti 2017, janë kryer hetimet përkatëse dhe në përfundim i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e procedimit për arsye të parashkrimit të veprës penale. Kjo për arsye se dokumenti i pretenduar i falsifikuar, i vërtetuar si i tillë me aktekspertimin teknik nr. ***, datë 18.9.2017, u provua se ndodhej në dosjen e këtij shtetasi që në datën 31.8.1995 (përmendet në vendimin e Komisionit të AKKP-së Kolonjë).

³⁴Për më shumë referojuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit administrativ.

³⁵Denoncim nr. *** prot., datë 12.2.2018, nga shtetasi Th. Gj..

³⁶Denoncim nr. *** prot., datë 9.11.2018, nga shtetasi H. K..

³⁷Shkresa nr. *** prot., datë 11.3.2021.

3.3 Me vendimin nr. ***, datë 23.11.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

4. **Denoncimet e z. V. N.**³⁸. Objekti i denoncimit: denoncon për zvarritje të hetimeve.

- a) Nga denoncuesi janë depozituar 13 denoncime lidhur me subjektin e rivlerësimit, të cilat kanë lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2017, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
- b) Denoncuesi më 17.5.2017 dhe shtetasi A. J. më 11.5.2017 kanë kallëzuar penalisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, përgjegjës in e Zyrës Arsimore Kolonjë, shtetasin S. D. për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, lidhur me disa emërime në kundërshtim me ligjin.
- c) Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2017, nga prokurori J. K., i cili ka kërkuar në datën 20.9.2017 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pushimin e kësaj çështjeje penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 30.10.2017, i cili është ndryshuar pjesërisht nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 30, datë 6.3.2018, kanë vendosur: “Kthimin e akteve, duke e urdhëruar prokurorin të vazhdojë hetimin sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese. Vazhdimin e hetimeve për rrethanat e tjera të pahetuara të çështjes, në drejtim të evidentimit të plotë të shkeljeve nga punonjësit e tjerë arsimorë.
- ç) Pas kthimit të akteve, procedimi penal është ndjekur nga prokurori Gentian Stoja, i cili përsëri ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë pushimin e procedimit penal ndaj të dyshuarit S. D.. Lidhur me këtë kërkim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. *** (***) SP, datë 20.5.2019, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 3.7.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë ka vendosur: “Mospranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2017, të regjistruar për veprën penale ‘shpërdorim të detyrës’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me person nën hetim të regjistruar S. D. dhe kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë për vazhdimin e hetimeve që duhet të përfundojnë brenda 2 muajve nga marrja e vendimit formë të prerë”.
- d) Denoncuesi shprehet se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur në mënyrë të pajustificuar procesin penal me pretekstin se “... në këto kushte kur del e domosdoshme ardhja e këtij akti të rëndësishëm për këtë hetim duhet të zgjatet afati hetimor i këtij procedimi penal për një periudhë 3 muaj ...”, duke e shtyrë 3 herë nga 3 muaj pa njoftuar për këtë shtyrje kallëzuesin dhe në dosje mungon akti i rëndësishëm për të cilin u zgjatën hetimet.
- dh) Lidhur me këtë rast, duket se hetimet nuk janë të plota, nuk janë kryer në mënyrë të plotë dhe shteruese veprime hetimore sipas drejtimit të thelluar të përcaktuar në vendimin nr. ***, datë 30.10.2017, ndryshuar pjesërisht nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 6.3.2018, të detyrueshme për t’u respektuar nga organi i prokurorisë. Shumë aspekte kanë mbetur pa hetuar në tërësi dhe kërkesa për pushim është bazuar vetëm në interpretim të ligjit.

4.1 Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit të rivlerësimit mbi shkaqet e pretenduara në këtë denoncim, si dhe arsyet e zgjatjes së afateve të hetimit dhe mosnjoftimin e kallëzuesit.

4.2 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit se lidhur me procedimin penal nr. 700, viti 2017, në ngarkim të shtetasit S. D. me detyrë ish-drejtor i Zyrës Arsimore *** i kallëzuar nga shtetasi V. N. për arsye se nuk ishte zgjedhur drejtor i gjimnazit ***. Po ashtu, ankohej edhe për procedurat e ndjekura nga Zyra Arsimore *** për lëvizje mësuesesh, komandime drejtore shkollash etj., që sipas tij ishin bërë në kundërshtim me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit. Pas kryerjes së veprimeve hetimore duke hetuar të gjitha pretendimet e kallëzuesit, ndonëse ai vazhdimisht dërgonte shkresa dhe kërkesa në prokurori, ku ngrinte pretendime të reja dhe kërkonte të hetoheshin edhe fakte të reja, të cilat normalisht kërkonin kohën e nevojshme për shqyrtim dhe analizim provash.

³⁸Denoncimet: nr. ***, datë 22.2.2019; nr. ***, datë 2.4.2019; nr. ***, datë 2.4.2019; nr. ***, datë 30.4.2019; nr. ***, datë 13.5.2019; nr. ***, datë 26.6.2019; nr. ***, datë 26.6.2019; nr. ***, datë 26.6.2019; nr. ***, datë 9.9.2019; nr. ***, datë 23.9.2019; nr. ***, datë 16.1.2020, nr. *** prot., datë 15.1.2020, nga shtetasi V. N..

4.3 Në bazë të nenit 324/3 të Kodit të Procedurës Penale vendimi për zgjatjen e afatit të hetimit i njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit. Me të pandehurin, për nga cilësimi i të drejtave, barazohet edhe personi nën hetim (që i është regjistruar emri në regjistrin e personave që i atribuohet vepra penale). Në rastin konkret, shtetasi V. N. nuk ka statusin e të dëmtuarit nga vepra penale, por vetëm atë të kallëzuesit për fakte dhe rrethana që ai pretendon se kanë ndodhur nën drejtimin e Zyrës së Arsimit ***.

4.4 Aktet e prokurorit i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor për vlefshmërinë ose jo të tyre dhe është gjykata ajo që shprehet për to. Në rastin konkret nuk ka asnjë vendimmarrje të gjykatës për sa më sipër pretendohet nga kallëzuesi.

4.5 Aktualisht, përsëri pas kryerjes së veprimeve hetimore nga prokurori i caktuar, ky procedim është dërguar për pushim në gjykatë për arsye se faktet e pretenduara nga shtetasi V. N. nuk përmbajnë elemente të figurës së veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

5. Denoncimi nga shtetasi P. D.³⁹. Objekti i denoncimit: denoncon për vendim të kundërligjshëm për mosfillimin e procedimit penal.

- a) Nga aktet e depozituara nga denoncuesi rezulton se ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në datën 6.3.2019 ndaj përmbaruesit A. S. për veprime të kundërligjshme, duke shpërdoruar detyrën lidhur me ekzekutimin mbi një pasuri të paluajtshme të tij, e cila ka kaluar në emër të kreditorit V. S.. Lidhur me këtë kallëzim penal, prokurori Gentian Stoja, me vendimin e datës 18.3.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal që ka lidhje me kallëzimin nr. ***, viti 2019.
- b) Lidhur me këtë denoncim Komisioni kërkoi⁴⁰ informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2021 dërgoi vendimin e subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e procedimit penal të datës 18.3.2019, si dhe vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nr. ***, datë 20.5.2019, me të cilin, pas kërkesës së kallëzuesit P. D. dhe të përfaqësuesve të tij për heqjen dorë nga vazhdimi i gjykimit të kësaj çështjeje, është vendosur pushimi i kërkesës penale për kundërshtimin e vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal.
- c) Sipas denoncuesit ai ka depozituar kallëzim penal ndaj përmbaruesit A. S. për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme duke shpërdoruar detyrën për arsye se ka nxjerrë vendimin e sekuestros datë 18.2.2019 ndaj makinerive të shoqërisë “****” sh.p.k., e cila nuk ka qenë debitor ndaj shtetasit V. S..
- ç) Lidhur me këtë kallëzim subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 13.3.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se veprimet e përmbaruesit kanë qenë korrekte dhe sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe nuk përmbajnë asnjë element të figurës së veprës penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
- d) Kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal, denoncuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.5.2019, ka vendosur pranimin e ankimit të denoncuesit dhe urdhërimin e prokurorit të çështjes Gentian Stoja të regjistrojë procedim penal dhe të kryejë veprime hetimore sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, prokurori i çështjes ka depozituar ankim pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
- dh) Gjithashtu, denoncuesi informon se ka depozituar një kallëzimin penal në datën 11.1.2021 dhe ka depozituar një kërkesë në Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për marrjen e masave me qëllim përjashtimin nga shorti të prokurorit Gentian Stoja.
- e) Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë informon Komisionin se bazuar në kallëzimin penal të shtetasit P. D. të datës 11.1.2021 është filluar procedimi penal nr. ***,

³⁹Denoncimet nr. *** prot., datë 4.4.2019; nr. *** prot., datë 24.7.2019; nr. *** prot., datë 18.1.2021 dhe nr. *** prot., datë 20.1.2021 nga shtetasi P. D..

⁴⁰Shkresa nr. *** prot., datë 11.3.2021.

për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe procedimi është nën hetim.

5.1 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit mbi shkaqet e pretenduara në këtë denoncim.

5.2 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit se: “... lidhur me pretendimet e shtetasit P. D. është e vërtetë sa është relatuar nga Komisioni. Mbi bazën e kallëzimit të shtetasit P. D. është marrë në trajtim kallëzimi penal nr. ***, viti 2019. Pas analizimit të provave dhe fakteve me vendim të datës 13.3.2019 është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Me marrjen dijeni, kallëzuesi është ankuar në gjykatë, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.5.2019, ka vendosur pranimin e ankimit të denoncuesit dhe urdhërimin e prokurorit të çështjes Gentian Stoja të regjistrojë procedim penal dhe të kryejë veprime hetimore sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, brenda afatit ligjor unë kam ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Aktualisht, ankimi nuk është shqyrtuar ende në Gjykatën e Apelit Korçë. Procedimin penal nr. *** nuk e kam unë në hetim, por prokuror tjetër. Sqaroj se lidhur me ankimet e shtetasit P. D. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. *** prot., datë 19.4.2021, ‘Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së shtetasit P. D.’ dhe vendimin nr. *** prot., datë 25.5.2021, ‘Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së shtetasit P. D.’, ku në këto vendime janë shqyrtuar të gjitha ankesat lidhur me të gjitha procedimet/kallëzimet që unë kam shqyrtuar me këtë shtetas, konkretisht, procedimet penale ***, *** dhe mosfillimet penale nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. ***, të pretenduara nga shtetasi P. D. (bashkëlidhur vendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë)”.

6. **Denoncimi nga shtetasja Xh. Q.**⁴¹. Objekti i denoncimit: denoncon për shkelje të rënda procedurale dhe ligjore.

- a) Denoncuesja, e cila vepron në emër të nënës së saj N. K. si përfaqësuese me prokurë të posaçme, ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë, duke pretenduar ndërhyrje në hartat treguese të pasurisë së paluajtshme nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Korçë, nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve, duke dëmtuar interesat e kallëzueses.
- b) Referuar fashikullit të procedimit penal të depozituar nga denoncuesja, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 9.9.2019, për veprën penale “shpërdorim detyrë”, të parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal, me prokuror Gentian Stoja.
- c) Lidhur me këtë procedim penal, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 23.9.2019, ka vendosur: “Të mosfillojë procedimin penal që ka lidhje me kallëzimin nr. ***, të vitit 2019”. Kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal, denoncuesja ka depozituar ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
- ç) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 29.10.2019⁴², ka vendosur mospranim e ankimit për moslegjitimim të ankeses. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kallëzuesja N. K. dhe me vendimin nr. ***, datë 1.7.2020, të Gjykatës së Apelit Korçë është vendosur: “Prishja e vendimit nr. ***, datë 29.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë të njëjtës gjykatë, me tjetër trup gjykues”.
- d) Me kthimin e çështjes për rigjykim nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është marrë në shqyrtim ankimi nga një trup tjetër gjykues dhe me vendimin nr. ***, datë 23.11.2020, ka vendosur: Pranimin e kërkesës. Prishjen e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë datë 23.9.2019 për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. ***, viti 2019, duke u urdhëruar prokurori të regjistrojë procedimin penal në lidhje me këtë kallëzim dhe të kryejë hetimet e nevojshme sipas drejtimit të përcaktuar nga gjykata në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. Kundër këtij vendimi prokurori ka paraqitur ankim

⁴¹Denoncim n. *** prot., datë 12.11.2019, nga shtetasja Xh. Q.

⁴²Vendim i shkarkuar nga website i Gjykatës së Apelit Korçë.

pranë Gjykatës së Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.1.2021⁴³, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 23.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”.

- dh) Lidhur me këtë denoncim, Komisioni kërkoi⁴⁴ informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 16.3.2021, informon se për procedimin penal nr. ***, të vitit 2019 është vendosur mosfillimi. Vendimi i mosfillimit është ankimuar në gjykatë dhe në zbatim të vendimit të gjykatës është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2021, i cili është nën hetim.
- e) Lidhur me këtë rast, duket se hetimet nuk janë të plota, nuk janë kryer në mënyrë të plotë dhe shteruese veprime hetimore sipas drejtimit të thëlluar të përcaktuar në vendimin nr. ***, datë 23.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 20.1.2021, të detyrueshme për t’u respektuar nga organi i prokurorisë. Shumë aspekte kanë mbetur pa hetuar në tërësi dhe kërkesa për pushim është bazuar vetëm në interpretim të ligjit.

6.1 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit mbi shkaqet e pretenduara në këtë denoncim.

6.2 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit se lidhur me pretendimet e shtetases Xh. Q. mbi bazën e kallëzimit të nënës së saj N. K., është marrë në trajtim kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2019. Pas analizimit të provave dhe fakteve me vendim të datës 23.9.2019 është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Me marrjen dijëni, kallëzuesi është ankuar në gjykatë, e cila me vendimin nr. ***, datë 29.10.2019, ka vendosur mospranim e ankimit për moslegjitimit të ankueses. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kallëzuesja N. K. dhe me vendimin nr. ***, datë 1.7.2020, të Gjykatës së Apelit Korçë është vendosur: “Prishja e vendimit nr. ***, datë 29.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë të njëjtës gjykatë, me tjetër trup gjykues.

6.3 Me kthimin e çështjes për rigjykim nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është marrë në shqyrtim ankimi nga një trup tjetër gjykues dhe me vendimin nr. ***, datë 23.11.2020, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës”. Prishjen e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë datë 23.9.2019 për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. ***, viti 2019, duke u urdhëruar prokurori të regjistrojë procedimin penal në lidhje me këtë kallëzim dhe të kryejë hetimet e nevojshme sipas drejtimit të përcaktuar nga gjykata në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. Kundër këtij vendimi, prokurori ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.1.2021⁴², ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 23.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

6.4 Sipas vendimit të gjykatës së Apelit Korçë është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2021, i cili është në hetim dhe po kryhen veprime procedurale nga OPGJ-ja, caktuar sipas ligjit. Vendimi i mosfillimit merret vetëm mbi bazën e akteve të sjella nga kallëzuesi dhe disa veprime hetimore paraprake. Në këtë rast nuk është bërë asnjëherë vendim pushimi.

7. **Denoncimi nga shtetasi A. Xh.**⁴⁵. Objekti i denoncimit: denoncon për mosvënie në dijëni për ecurinë e procedimit penal.

- a) Denoncuesi, me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë “***” sh.p.k., ka kallëzuar penalisht në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë drejtuesin e Bashkisë *** për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
- b) Sipas denoncuesit, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë u regjistrua procedimi penal dhe nga prokurori i çështjes Gentian Stoja prej muajit prill 2019 edhe pas interesimit të herë pas herëshëm të administratorit të shoqërisë dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në mënyrë arrogante dhe të papërgjegjshme, nuk i ka pritur në takim dhe nuk iu ka kthyer përgjigje kërkesave lidhur me vënien në dijëni për ecurinë e procedimit penal.

7.1 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit mbi shkaqet e pretenduara në këtë denoncim, si dhe veprimet hetimore të kryera për këtë procedim penal.

⁴³Vendim i shkarkuar nga website i Gjykatës së Apelit Korçë.

⁴⁴Shkresa nr. *** prot., datë 11.3.2021.

⁴⁵Denoncim nr. *** prot., datë 14.2.2020, nga shtetasi A. Xh..

7.2 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit se: “... lidhur me shtetasin A. Xh. Prokuroria Korçë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2018, pa emër personi konkret të regjistruar në regjistrin e veprave penale duke kryer hetime për veprën penale “shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe “fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal. Pas përfundimit të hetimeve shteruese, prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018. Në përfundim të hetimit ky shtetas është njoftuar dhe ka ardhur ka tërhequr materialet te zyra e kryesekretarisë. Gjatë gjykimit ka qenë i pranishëm vetë shtetasi A. Xh. me mbrojtësin e tij dhe në përfundim të gjykimit me vendimin nr. ***, datë 4.11.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018. Pas ankimimit të kallëzuesit A. Xh., me vendimin nr. ***, datë 29.12.2020, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 4.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Pretendimet e denoncuesit janë të pavërteta dhe dashakeqe për arsye se shoqëria “****”, themeluar nga shtetasi A. Xh. është dënua për veprën penale “fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal me vendimin nr. ***, datë 30.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pretendimet e tij se nuk ka dijeni për përfundimin e procedimit penal janë të gënjeshtërt sepse ka qenë prezent në gjykim, ka marrë dijeni për zhvillimin e gjykimit dhe ka ushtruar po ai vetë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Korçë. Pretendimet e tij të herëpashershme kanë qenë për faktin se përse unë në cilësinë e prokurorit i kisha zgjeruar hetimet edhe për firmën e tij për fshehje të ardhurash, gjë e cila doli gjatë hetimit dhe u dënua nga gjykata kompetente ku ka adresën e regjistrimit subjekti tregtar”.

8. Denoncimi nga shtetasja F. M.⁴⁶. Objekti i denoncimit: denoncon për paaftësi të subjektit të rivlerësimit. Nga denoncuesi është depozituar edhe vendimi nr. ***, datë 15.11.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe vendimi nr. ***, datë 15.1.2019, i Gjykatës së Apelit Korçë. Nga rrethanat e denoncimit dhe vendimet e gjykatave të depozituara nga denoncuesi, konstatohet se shtetasja F. M. është pjesë e një konflikti civil me kunatin e saj shtetasin Gj. M., lidhur me një sipërfaqe truall prej 1500 m² të dhuruar, për të cilën në ZVRPP Korçë rezultojnë me mbivendosje me pronarët kufitarë.

- a) Denoncuesi ka bërë kallëzim penal në datën 28.8.2018 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me falsifikimin e dy planeve të rilevimit nga punonjësit e ZVRPP-së Korçë, në bazë të të cilëve prona e saj del me mbivendosje, si dhe shpërdorim detyre nga ana e tyre, pasi planet e rilevimit nuk duhet të hartoheshin prej tyre. Lidhur me kallëzimin penal, prokurori Gentian Stoja me vendimin e datës 18.9.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.
- b) Ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, denoncuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke kërkuar prishjen e këtij vendimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 15.11.2018, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës për prishjen e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë të datës 18.9.2018”, duke urdhëruar prokurorin të regjistrojë procedim penal në lidhje me këtë kallëzim dhe të kryejë hetimet e nevojshme sipas drejtimit të përcaktuar nga gjykata në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 15.1.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë.
- c) Në bazë të vendimeve të mësipërme konstatohet se: “Gjykata e Apelit sikurse dhe Gjykata e Shkallës së Parë, vëren që konkluzioni i arritur nga organi i akuzës lidhur me mungesën e elementeve të veprës penale ‘falsifikim të dokumenteve’ apo ‘shpërdorim të detyrës’ të kallëzuar nga kërkuesja, është i pambështetur dhe nuk mund të arrihej vetëm me një shqyrtim sipërfaqësor të referuar veprimeve procedurale të kryera, pa kryer hetime të mëtejshme si rezultat i të cilave do të arrihej në një përfundim të saktë nëse fakti i referuar dhe ngjarja e ndodhur përmban ose jo elemente të ndonjë vepre penale”.

⁴⁶Denoncimi nr. *** prot., datë 11.9.2020, nga shtetasja F. M..

ç) Lidhur me këtë rast, duket se hetimet nuk janë të plota, nuk janë kryer në mënyrë të plotë dhe shteruese veprime hetimore sipas drejtimit të thelluar të përcaktuar nr. ***, datë 15.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 15.1.2019, të detyrueshme për t'u respektuar nga organi i prokurorisë. Shumë aspekte kanë mbetur pa hetuar në tërësi dhe kërkesa për pushim është bazuar vetëm në interpretim të ligjit.

8.1 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit mbi shkaqet e pretenduara në këtë denoncim.

8.2 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit se: *“... lidhur me pretendimet e shtetases F. M. mbi bazën e kallëzimit të saj është marrë në trajtim kallëzimi penal nr. ***, datë 4.9.2018. Pas analizimit të provave dhe fakteve me vendim të datës 18.9.2018, është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Me marrjen dijeni, kallëzuesi është ankuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 15.11.2018, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës për prishjen e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë të datës 18.9.2018, duke urdhëruar prokurorin të regjistrojë procedim penal në lidhje me këtë kallëzim dhe të kryejë hetimet e nevojshme sipas drejtimit të përcaktuar nga gjykata në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 15.1.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë.*

Lidhur me këtë material kallëzues, meqë kallëzuesja ka kërkuar në seancë gjyqësore unë kam hequr dorë nga trajtimi i tij pas kthimit nga Gjykata e Apelit Korçë që në datën 7.3.2019. Procedimi është regjistruar dhe ndiqet nga tjetër prokuror. Që prej datës 7.3.2019 unë nuk kam kryer asnjë veprim lidhur me sa pretendon kallëzuesja. Pretendimet e saj nuk janë të vërteta”.

60. Nga verifikimi i sistemit TIMS rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka lëvizur shumë shpesh nga territori i Republikës së Shqipërisë për në Greqi dhe anasjelltas me automjete në emër të personave të ndryshëm: A. N. M.; E. A. A.; A. A. V.; D. S. S.; V. J. T.; M. B. T.; B. B. K. (përdorues A. G. M.); S. B. B. (shoqëria “***”); S. K. Dh.; J. K. Dh.; K. N. L.; G. Q. D. dhe R. H. D. (shoqëria “***”); E. Ll. Q.; dhe V. S. M..

60.1 Komisioni kërkoi informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me çdo procedimin penal apo kallëzim ndaj tyre. Nga informacioni i dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezultoi se:

- a) Ndaj shtetasit E. A. është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, viti 2019, për veprën penale “mashttrim”, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal.
- b) Ndaj shtetasit A. M. është regjistruar çështja penale nr. ***, viti 2016, për veprën penale “mashttrim”, për të cilin është vendosur pushimi i çështjes penale.
- c) Ndaj shtetasit J. Dh., rezultojnë si vijon:
 - i. regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2014, për veprën penale “vjedhje”, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes penale;
 - ii. regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2006, për veprën penale “falsifikim”, për të cilin është vendosur pushimi i çështjes penale;
 - iii. është dërguar për gjykim procedimi penal nr. ***, viti 2013, për veprën penale “deklarime të rreme para OPGJ-së”, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. ***, datë 4.12.2013, ka vendosur të deklarojë fajtor shtetasin J. Dh. për këtë vepër penale dhe ta dënojë me vlerën 120,000 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë;
 - iv. është dërguar për gjykim procedimi penal nr. ***, viti 2011, për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të policisë”, për të cilin nuk kemi informacion mbi vendimin e gjykatës.

ç) Ndaj shtetasit V. M. është regjistruar çështja penale nr. ***, viti 2010, për veprën penale “kontrabandë me mallra të tjerë”, për të cilin është vendosur pushimi i çështjes penale.

60.2 Në përfundim, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të argumentojë bindshëm se:

- a) personat me automjetet e të cilëve ka lëvizur në drejtim të shtetit grek nuk janë kontakte të papërshtatshme në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

- prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- b) nëse përbën shkelje të etikës së prokurorit të Republikës së Shqipërisë miqësia dhe udhëtimi me personat e mësipërm me precedentë penal dhe që kanë qenë nën hetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;
- c) lidhur me procedimin penal nr. ***, të vitit 2014, ndaj shtetasit J. Dh., për veprën penale “vjedhje”, të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, për të cilën ka vendosur pushimin e çështjes penale, mbështetur në të dhënat në sistemit *TIMS*, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar 1 herë me të vëllanë, shtetasin S. Dh., dhe automjetin e këtij të fundit me targa ***, në drejtim të Greqisë, nga pika e kalimit kufitar Kapshticë, në datën 14.3.2012, ora 08:31 dhe është kthyer brenda ditës në orën 15:21. Duket se subjekti i rivlerësimit ka miqësi dhe njohje me këta shtetas dhe në vitin 2014 ka hetuar çështjen në kushtet e konfliktit të interesit.

60.3 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Lidhur me trajtimin me cilësinë e prokurorit të çështjes penale ndaj shtetasit J. Dh. në procedimin penal nr. ***, të vitit 2014, unë nuk kam pasur asnjë kontakt me shtetasin J. Dh. dhe nuk kisha mundësi objektive të dija se ai ishte vëllai i shtetasit S. Dh., me të cilin kisha udhëtuar vetëm një herë në mënyrë të rastësishme në mars të vitit 2012. Pra, dy vjet përpara se të caktohesha për ndjekjen e kësaj çështjeje. Nuk kam pasur asnjë shkak të parashikuar në nenet 15,16, 17 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohen rastet e zëvendësimit ose përjashtimit të prokurorit nga hetimi i një çështjeje të caktuar si pasojë e konfliktit të interesit të përcaktuar në këto dispozita ligjore”.*

60.4 Subjekti i rivlerësimit ka informuar Komisionin se në vlerësim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” “kontakt i papërshtatshëm” është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni, ose ndonjë marrëdhënie tjetër, duke sqaruar se ai nuk i konsideron personat me automjetet e të cilëve ka lëvizur në drejtim të shtetit grek, të janë kontakte të papërshtatshme në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

61. Në një vlerësim të përgjithshëm të denoncimeve dhe të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me to, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara prej tij, e cila mund të çonte në një mungesë të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, por se disa sjellje dhe veprime të subjektit të rivlerësimit mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin në tërësi të çështjes, lidhur me rivlerësimin e subjektit Gentian Stoja, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

62. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga vlerësimi tërësor i çështjes, duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar, të drejtën e pretenduar dhe qëllimin që synohet të arrihet, të gërshetuara me njëra-tjetrën, konstatoi se subjekti i rivlerësimit me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Në këtë logjikë, në faktet dhe në provat e referuara në vendim, bazuar në

germën “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Komisionit, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Stoja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Ky vendim, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.6.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar/Kundër

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku

<i>Ne detyre 10.12.2009</i>								
Gentian Stoja								
Prokuror pranë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë								
Monedha Leke							Rezultat Negativ - 512.285	
	10.12.2009-31.12.2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	-49.001	114.398	247.480	577.802	-200.222	190.776	26.000	60.709
Apartament Banimi 89.76m2			-					
Automjet Volkswagen Sharan				700.000				
<i>Shtesa/Pakesime likuiditete</i>	<i>-49.001</i>	<i>114.398</i>	<i>247.480</i>	<i>-122.198</i>	<i>-200.222</i>	<i>190.776</i>	<i>26.000</i>	<i>60.709</i>
Likuiditete Gjendje	13.234.100	13.348.498	13.595.978	13.473.780	13.273.558	13.464.334	13.490.334	13.551.043
DETYRIME	-	-	-	-	-	-	-	-
PASURI NETO = Pasuri - Detyrime	-49.001	114.398	247.480	577.802	-200.222	190.776	26.000	60.709
	10.12.2009-31.12.2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
TE ARDHURA	9.000	856.210	1.062.224	1.024.063	926.115	1.098.520	1.063.386	1.247.823
Te ardhura nga paga e subjektivit	9.000	856.210	961.352	918.100	920.527	1.094.720	1.060.447	1.080.472
Te ardhura nga paga e b/shortes								165.587
Te ardhura nga qeraja		0	0	0	0	0	0	
Dhurate nga prinderit ne mjete monetare			100.000					
Te ardhura neto nga interesi i depozites			872	5.963	5.588	3.800	2.939	1.764
Te ardhura nga shitja e automjetit Honda				100.000				
SHPENZIME	49.155	882.643	833.379	718.834	696.645	882.936	775.330	1.267.359
Shpenzime jetese	34.155	322.660	366.935	348.644	380.072	620.946	616.128	928.948
Shpenzime TIMS	0	151.962	134.344	137.807	91.510	22.817	81.137	179.304
Shpenzime nga b.shortja e subjektivit		154.500	227.700	218.088	213.562	195.150		
Shpenzime interesi		9.521	0	-305	4.301	13.928	4.396	2.079
Shpenzime qeraje	15.000	180.000	0					
Shpenzime arredimi		56.000	100.000					
Shpenzime te tjera		8.000	4.400	14.600	7.200	30.096	73.668	157.028
Rezultati= te ardhura - shpenzime - pasuri neto	8.846	-140.831	-18.635	-272.574	429.692	24.808	262.056	-80.245